



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 12/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.01.2020, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-30830-07-18-2019, me objekt “Për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 1.117.059.801 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara”.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k.
Rruga “Teodor Keko”, P. Pelivani, Unaza e Re, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë

Subjekt i interesuar: “AGS” sh.p.k.
Rruga “Beqir Luga”, Pallati nr. 3, shk. 1/1, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 30830-07-18-2019, me objekt “Për shërbimin e lavyerisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 1.117.059.801 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 03.09.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, si edhe nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | | |
|----|---|------------------------------------|
| 1. | Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. | 1.012.676.242,5 lekë, skualifikuar |
| 2. | “AGS” sh.p.k. | 1.111.482.284,5 lekë, skualifikuar |
| 3. | “Devis” sh.p.k. | 1.117.059.793 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Albanian Distribution Chem” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 5. | “W. Center” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

Në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor informon se, pas paraqitjes së ankesave pranë këtij të fundit, është pranuar ankesa e operatorit ekonomik “AGS” sh.p.k. ku rezulton si më poshtë:

- | | | |
|----|---|------------------------------------|
| 1. | Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. | 1.012.676.242,5 lekë, skualifikuar |
| 2. | “AGS” sh.p.k. | 1.111.482.284,5 lekë, kualifikuar |
| 3. | “Devis” sh.p.k. | 1.117.059.793 lekë, skualifikuar |
| 4. | “Albanian Distribution Chem” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |
| 5. | “W. Center” sh.p.k. | nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 18.09.2019 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

1. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 19042917243251703, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar “Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018” nuk është i nënshkruar nga anëtarë i BOE-së Servizi Italia SPA.

2. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2017” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 18043013003466134, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin.

Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2018 - Periudha tatimore 2017" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

3. Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2016" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 17022812551019395, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2017 - Periudha tatimore 2016" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

4. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2016 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/1509/2017/CPRAUTO datë 12.05.2017, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

5. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2017 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/12732/2018/CPRAUTO, datë 14.05.2018, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT

6. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/210570/2019/CPRAUTO, datë 19.06.2019; lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Të tre vërtetimet për paraqitjen e Bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin.

Ky vërtetim është i pavlefshëm, pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

7. Dokumenti "Konfirmim i xhiros" i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019 nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.2(1) "Kapaciteti teknik" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

8. I gjithë dokumentacioni i vetdeklaruar në institucionin italian INAIL, i paraqitur ne tender nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA, për të provuar pasjen e fuqisë punëtore, është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuar me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

9. Dokumentacioni "Njoftim i detyrueshëm" i Administratës së Provincës Parma - Shërbimi i Formimit Profesional dhe Politikave Aktive të Punës, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Për rrjedhim, ofertuesi BOE - Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK nuk arriti të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3 (3) të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, për fuqinë punëtore.

II.4. Në datën 25.09.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij duke ngritur pretendimet si më poshtë vijon:

[...]

Më datë 03.09.2019, kemi paraqitur ofertën tonë si BOE Servizi Italia SPA & Sanitary Cleaning shpk, duke ofruar cmim ekonomik mjaft të favorshëm dhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK.

Më datë 18.09.2019, u njoftuam në SPE për rezultatet e vlerësimit të ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>BOE SANITARY CLEANING</i>	<i>1012676242.50</i>	<i>Po</i>
<i>AGS</i>	<i>1111482284.50</i>	<i>Po</i>
<i>DEVIS</i>	<i>1117059793.00</i>	<i>Po</i>

Në po të njejtën datë në SPE janë njoftuar dhe arsytet e refuzimit të ofertës sonë, dhe konkretisht KVO shprehet: "Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 19042917243251703, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

2. Dokumenti i "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2017" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 18043013003466134, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile , duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financ iar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2018 - Periudha tatimore 2017" nuk është i nënshkruar nga anëtar i i BOE-së Servizi Italia SPA.

3. Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2016" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 17022812551019395, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2017 - Periudha tatimore 2016" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Serviz i Italia SPA.

4. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2016 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr.PRA/1509/2017/CPRAUTO datë 12.05.2017, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

5. Dokumenti “Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma”, të bilancit për vitin 2017 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr.PRA/12732/2018/CPRAUTO, datë 14.05.2018, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT

6. Dokumenti “Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma”, të bilancit për vitin 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/210570/2019/CPRAUTO, datë 19.06.2019; lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Të tre vërtetimet për paraqitjen e Bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm, pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

7. Dokumenti “Konfirmim i xhiros” i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019 nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.2(1) "Kapaciteti teknik" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

8. I gjithë dokumentacioni i vetdeklaruar në institucionin italian INAIL, i paraqitur ne tender nga anëtar i i BOE-së Servizi Italia SPA, për të provuar pasjen e fuqisë punëtore, është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noter i publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për

evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij

9. Dokumentacioni "Njoftim i detyrueshëm" i Administratës së Provincës Parma - Shërbimi i Formimit Profesional dhe Politikave Aktive të Punës, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Për rrjedhim, ofertuesi BOE - Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK nuk arriti të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3 (3) të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, për fuqinë punëtore

Shkaqet e mësipërme për skualifikimin tonë, i kundërshtojmë si vijon:

I. Në lidhje me shkaqet (1), (2) dhe (3) të skualifikimit

Kërkesa përkatëse në pikën 3 të Shtojcës 8, pika 3.1.1, lexon si vijon: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit"

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, ne kemi depozituar në SPE, si pjesë të ofertës:

(i) Deklaratat e xhiros vjetore për vitin 2016, 2017 dhe 2018 të shoqërisë Servizi Italia (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2016", "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2017" dhe "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2018") së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

(ii) Provën e depozitimit në formë elektronike të këtyre Deklaratave, në Agjencinë e të Ardhurave (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.1 2017 Ricevuta Invio Telematico IVA", "SI 3.1.1 2018 Ricevuta Invio Telematico IVA" dhe "SI 3.1.1 2019 Ricevuta Invio Telematico_IVA"), së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe; dhe

(iii) Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

Me paraqitjen e dokumentave të mësipërme ne kemi ofruar provë të plotë për përmbushjen e kriterit dhe pretendimet e ngritura nga KVO e AK nuk qëndrojnë për arsytet në vijim:

a. KVO pretendon se "Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018" nuk është i njëjshuar me origjinalin" e njësoj edhe për dokumentat e viteve të tjera.

Sqarojmë se dokumenti të cilit i referohet AK, në origjinalin e vet është një dokument elektronik, me specifikisht një konfirmim në formë elektronike i komunikimit elektronik të të dhënave. Kjo provohet nga vetë përmbajtja e dokumentit referencat ligjore respektive ku përcaktohet se:

- Referenca ligjore e ekzistencës së tij është neni 3, pg.10 i Dekretit të Presidentit të Republikës nr.322/1999 (Shtojca 3). Më konkretisht kjo dispozitë lexon sa vijon: "Prova e paraqitjes së deklaratës realizohet nga mandati i bankës ose të postës ose nëpërmjet mandatit të dërgesës rekomande të përmendur në paragrafin 5, ose nga komunikimi i administratës financiare që vërteton marrjen e deklaratës së paraqitur në mënyrë elektronike".
- Vetë dokumenti përcakton se lëshohet sipas Dekretit drejtues (Ministria e Financave) të datës 31/07/1998 "Modalita' tecniche di trasmissione telematica delle dichiarazioni e dei contratti di locazione e di affitto da sottoporre a registrazione, nonche' di esecuzione

telematica dei pagamenti" me ndryshimet përkatëse (Shtojca 4). Më specifikisht, neni 9, pg. 8 i këtij Dekreti përcakton se: "Me përjashtim të rasteve të forcës madhore, konfirmimet e paraqitjes bëhen të disponueshme në mënyrë elektronike brenda pesë ditëve të punës nga dërgimi i dosjeve të deklaratës të cilave u referohen dhe për një periudhë jo më pak se tridhjetë ditë pune" .

- *Gjithashtu, operatori ekonomik i huaj Servizi Italia ka deklaruar në Annex 8 të paraqitur si pjesë e dokumentave të ofertës së BOE, se sipas Dekretit Legjislativ 82/2005 "Codice dell'amministrazione digitale" (Shtojca 5), të gjitha dokumentat e prodhuara nga autoritetet publike italiane janë elektronike/dixhitale. Më specifikisht në nenin 5 bis të këtij ligji, përcaktohet se: "Paraqitja e kërkesave, deklaratave, të dhënave dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve, qoftë edhe për qëllime statistikore, midis kompanive dhe administratave publike bëhet ekskluzivisht duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Me të njëjtat metoda administratat publike miratojnë dhe komunikojnë akte dhe masat administrative ndaj kompanive".*

Është e qartë, se kemi të bëjmë me një dokument i cili në origjinal është në versionin elektronik dhe si i tillë është depozituar në SPE. Për efekt të noterizimit të përkthimit, dokumenti është printuar dhe i është bashkëlidhur dokumentit të përkthyer në shqip, por ky nuk është kopje e origjinalit, por vetëm printim i dokumentit origjinal, i cili është depozituar vecan në SPE, pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë është depozituar vetë origjinali.

b. KVO pretendon se "Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile".

Së pari, sic sqaruar edhe më sipër, ky dokument nuk mund të jetë i nënshkruar si dokumentat zyrtarë të prodhuar në letër, pasi është në vetvete nuk është një akt i mirëfilltë administrativ, por dokument që shërben si provë/konfermë e komunikimit elektronik.

Së dyti, duke mos qenë akt administrativ i mirëfilltë, ky nuk është një dokument nga ato që ka të detyrueshme pajisjen me vulë elektronike/dixhitale, pasi është një dokument dixhital i formës "konfermë elektronike", autenticiteti i të cilit, në përputhje me aktet ligjore italiane të cituara më sipër, sigurohet nëpërmjet autentifikimit të llogarive të përdoruesve në seicilin prej skajeve të komunikimit, nga një anë llogaria e përdoruesit të administratës publike dhe nga ana tjetër, llogaria e certifikuar e përdoruesit nga kompania.

Së treti, në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitale.

c. KVO pretendon se "... dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA".

Edhe për këtë pretendim të KVO, sic sqaruar më sipër, aktet ligjore dhe nënligjore italiane në fuqi dhe konkretisht Dekreti Legjislativ 82/2005 "Codice dell'amministrazione digitale" dhe Dekreti drejtues (Ministria e Financave) i datës 31/07/1998, përcaktojnë ndër të tjera që transmetimi dhe paraqitja e deklarimeve si ai i xhiros, bëhen nëpërmjet përcjelljes elektronike të

këtyre deklaratimeve nga kompanitë, sipas formularëve (moduleve elektronikë) të miratuar paraprakisht, duke përdorur llogaritë e autentifikuara/certifikuara të përdoruesve.

Pra, nuk ka se si të kërkohet që ky dokument të jetë i nënshkruar nga shoqëria Servizi Italia, pasi nënshkrimi që përdoret zakonisht në dokumentat në letër, në këtë rast është zëvendësuar nga autentifikimi/certifikimi i llogarisë së përdoruesit, sipas modaliteteve të përcaktuara në legjislacionin italian në fuqi.

d. Së fundmi sqarojmë se kriteri i vendosur nga AK në Dokumentat e Tenderit, në vetvete kërkon paraqitje të "kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore", pa cilësuar në mënyrë specifike që kërkohet edhe provë dokumentare e depozitimit të këtyre deklaratave. Pra kuptohet lehtësisht që depozitimi në SPE nga ana jonë i dokumentave "Komunikim i marrjes së deklaratës" është një depozitim fakultativ për të ofruar garanci shtesë për AK.

Pra, shkaqet e skualifikimit (1), (2) dhe (3) nuk qëndrojnë.

II. Në lidhje me shkaqet (4), (5) dhe (6) të skualifikimit

Kërkesa përkatëse në pikën 3 të Shtojcës 8, pika 3.1.1, lexon si vijon: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore".

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, ne kemi depozituar në SPE, si pjesë të ofertës:

(i) Bilancet e shoqërisë Servizi Italia për vitet 2016, 2017 dhe 2018 (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2016_EN", "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2017 EN" dhe "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2018_EN") së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

(ii) Provën e depozitimit në formë elektronike të këtyre Bilanceve (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.2 FS 2016 official submission", "SI 3.1.2 FS 2017 official submission" dhe "SI 3.1.2 FS 2018 official submission"), së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe; dhe

(iii) Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

Me paraqitjen e dokumentave të mësipërme ne kemi ofruar provë të plotë për përmbushjen e kriterit dhe pretendimet e ngritura nga KVO e AK nuk qëndrojnë për arsyet në vijim:

a. KVO pretendon se "Dokumentat "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, nuk përmban vulën Apostile" dhe në vecanti për dokumentin e paraqitjes së bilancit të vitit 2017 se "... nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale)".

Së pari, sic sqaruam edhe më sipër, këto dokumenta nuk mund të pajisen me apostile, pasi janë dokumenta të komunikimit elektronik/dixhital. Në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se

legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitalë.

Së dyti, në vetvete këto dokumenta nuk janë akte të mirëfilltë administrative, por transmetime elektronike që shërbejnë si provë/konfermë e komunikimit elektronik.

Së treti, duke mos qenë akte administrative të mirëfillta, këto nuk janë nga ato dokumente që e kanë të detyrueshme pajisjen me vulë elektronike/dixhitale, pasi është një dokument dixhital i formës "konfermë elektronike", autenticiteti i të cilit, në përputhje me aktet ligjore italiane të cituara më sipër, sigurohet nëpërmjet autentifikimit të llogarive të përdoruesve në secilin prej skajeve të komunikimit. Edhe kur këto dokumenta kanë nënshkrim elektronik kjo është fakultative dhe pa ndikim në vlefshmërinë apo autenticitetin e komunikimit, pasi gjendet aty thjesht për arsye të referimit arkivor dixhital. Sqarojmë gjithashtu, se këto dokumenta, në të cilat nënshkrimi elektronik nuk është kusht për autenticitetin dhe vlefshmërinë, kur printohen apo transmetohen në llogari të të tretëve të paautentifikuara si llogari të certifikuara, mund edhe ta humbin nënshkrimin elektronik të origjinës.

Së fundmi, sqarojmë se kriteri i vendosur nga AK në Dokumentat e Tenderit, në vetvete kërkon paraqitje të "kopjeve të certifikuara të bilanceve", pa cilësuar në mënyrë specifike që kërkohet edhe provë dokumentare e paraqitjes së tyre në autoritetet tatimore. Sic edhe është referuar në pikën 3 të Annex të "Auto-Deklaratë" të paraqitur nga operatori ekonomik i huaj, nga ana e këtij OE pjesëtar i BOE janë paraqitur të gjitha ato dokumenta të kërkuara për plotësimin e kriterëve në pikat 3.1 dhe 3.2 të Shtojcës 8 të Dokumentave të Tenderit që janë të mundshme sipas legjislacionit Italian. Sipas legjislacionit italian, nuk ekziston një dokument që provon paraqitjen e bilanceve në autoritetet tatimore, pasi nuk ekziston një detyrim ligjor i tillë. I vetmi autoritet në Itali, ku depozitohen bilancet, është Cammera Di Commercio (si QKB në Shqipëri). Pra kuptohet lehtësisht që depozitimi në SPE nga ana jonë i dokumentave "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", është një depozitim fakultativ prej nesh, për të ofruar garanci shtesë për AK përveç detyrimit të plotësuar nëpërmjet Auto-Deklarimit në Annex 8.

b. KVO pretendon se "Të tre vërtetimet për paraqitjen e Bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin".

Së pari, sic kemi sqaruar më sipër, është e qartë, se kemi të bëjmë me dokumenta, ose më saktë komunikime elektronike të të dhënave, të cilat në origjinal ekzistojnë vetëm në versionin elektronik. Për efekt të noterizimit të përkthimit, këto dokumenta printohen bashkohen e lidhen me vulat e noterit me dokumentat e përkthyer në shqip, si edhe skanohen nga versioni print për tu upload në SPE, por nuk mund të konsiderohen si kopje të origjinalit, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston në letër.

Për më tepër, sic edhe sqaruam më sipër këto nuk janë dokumenta të mirëfillta por komunikime elektronike të të dhënave, pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë nuk ekziston një i tillë në letër.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e KVO se Vërtetimet e përkthimit janë të pavlefshme sepse kanë vetëm numër repertori dhe jo datë, sqarojmë se:

- *Ligji Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në nenin 3 gërma "ë", nenet 62, 63, 97, 106 dhe në Kreun III të ligjit, përcakton në mënyrë të qartë aktet noteriale si të dallueshme nga veprimet noteriale. Gjithashtu, është e qartë se Ligji në fjalë, por edhe Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale" i cituar nga KVO, "vërtetimin e përkthimit" e përcakton si "veprim noterial" dhe jo si "akt noterial".*
- *Neni 105 i Ligjit Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", të cilit i referohet KVO, bën fjalë për detyrueshëm të "aktit noterial" dhe kjo del qartë duke filluar që nga titulli i nenetit dhe më tej nga përmbajtja e tij, ku specifikisht i referohet "aktit noterial" pa përfshirë "veprimin noterial". Nga ana tjetër edhe neni 135 të cilit i referohet KVO, që rregullon veprimin noterial të "vërtetimit të përkthimeve" nuk bën fjalë për datën si element të detyrueshëm.*
- *KVO e AK, në mënyrë tërësisht të kundraligjshme, deklaroi se vërtetimet e përkthimeve në fjalë konsiderohen "të pavlefshme". Kjo për dy arsye: (i) sepse sipas nenetit 137 të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", janë përcaktuar qartë rastet e pavlefshmërisë së aktit noterial dhe veprimit noterial, dhe mungesa e datës (gërma "d" dhe "e" e nenetit) e përcaktojnë mungesën e datës si element pavlefshmërie vertëm për aktin noterial dhe jo edhe për veprimin noterial; dhe (ii) sipas nenetit 138 të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", rezultoi qartë se akti ose veprimi noterial deklarohen të pavlefshëm vetëm nga Gjykata pasi kjo është vënë në lëvizje nga personat e treguar në këtë nen. Pra KVO nuk ka asnjë tagër të deklarojë pavlefshmërinë e këtyre veprimeve noteriale.*
- *Së fundmi, për të qartësuar më mirë këtë qëndrim të kundraligjshëm të KVO, po paraqesim bashkëlidhur kësaj Ankese Shtojcën 6, nëpërmjet të cilës konfirmohet edhe një herë nga noteri rregullshmëria e vërtetimeve të përkthimit të bera prej saj, të depozituara në këtë procedurë.*

Pra, shkaqet e skualifikimit (4), (5) dhe (6) nuk qëndrojnë

III. Në lidhje me shkakun (7) të skualifikimit

a. KVO pretendon se "Dokumenti "Konfirmim i xhiros" i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019 nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile".

Sic e kemi sqaruar edhe më sipër, ky dokument i lëshuar nga një autoritet publik, është një dokument dixhital i lëshuar me nënshkrim elektronik. Këtë fakt e kemi provuar edhe nëpërmjet depozitimit në SPE të dokumentit të emërtuar "SI 3.2 1 verifica firma digitale attestazione Ist Rizzoli". Në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitalë.

b. KVO pretendon se "Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin".

Së pari, sic kemi sqaruar më sipër, është e qartë, se kemi të bëjmë me dokumenta dixhitalë të nënshkruar elektronikisht. Për efekt të noterizimit të përkthimit, këto dokumenta printohen bashkohen e lidhen me vulat e noterit me dokumentat e perkthyer në shqip, si edhe skanohen nga versioni print për tu upload në SPE, por nuk mund të konsiderohen si kopje të origjinalit, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston në letër. Pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë nuk ekziston një i tillë në letër por vetëm dokumenti dixhital/elektronik.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e KVO se Vërtetimet e përkthimit janë të pavlefshme, e kemi sqaruar kundërshtimin tonë me argumentat në pikën II.b më sipër në këtë ankesë.

Pra, shkakut i skualifikimit (7) nuk qëndron

I. Në lidhje me shkaqet (8) dhe (9) të skualifikimit

Për sa i përket shkakut (8) të skualifikimit, për të evituar rënien në përsëritje, ju referojmë në sqarimin e kundërshtimit tonë me argumentat në pikën II.b më sipër në këtë ankesë.

Për sa i përket shkakut (9) të skualifikimit, për të evituar rënien në përsëritje, ju referojmë në sqarimin e kundërshtimit tonë me argumentat në pikën I.b dhe II.a më sipër në këtë ankesë.

Pra, shkaqet e skualifikimit (8) dhe (9) nuk qëndrojnë.

Në përfundim, duam të theksojmë se, ne kemi ofruar në këtë procedurë vlerën ekonomikisht më të favorshme me një diferencë prej rreth 98 milion lekë ose 820.000 Euro, dhe për më tepër anëtari i BOE Servizi Italia s.p.a është kompania lider në Itali dhe me përmasa e shtrirje të sukseshme ndërkombëtare për ofrimin e këtij shërbimi. Kjo do të thotë, se cdo artific i krijuar për skualifikim të sforcuar të ofertës sonë, nëse do të synohej në lidhjen e kontratës me vlerë më të madhe do, jo vetëm do të shkaktonte dëm ekonomik për buxhetin, por edhe do të cënonte rëndë interesin publik, duke mohuar ofrimin e shërbimit nga një operator me kredenciale të forta dhe histori suksesi ndërkombëtare.

II.5. Në datën 02.10.2019, me shkresën nr. 1648/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën, ndërkohë që ankimuesi pretendon se është njohur me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor në datën 04.10.2019.

Konkretisht autoriteti kontraktor i kthen përgjigjen ankimuesit duke argumentuar si më poshtë:

Prane Agjencise se Blerjeve te Perqendruara eshte depozituar ankesa protokolluar me tonen nr.1648 prot. date 25.09.2019 nga ofertuesi Bashkimi i Operatoreve Ekonomik (BOE) "Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK" per vleresimin e ofertes se paraqitur ne proceduren e prokurimit "Procedure e Hapur - Mbi kufirin e larte monetar - Kontrate Publike" me objekt: "Per sherbimin e lavanderise dhe hotelerise per pacientet e hospitalizuar ne pavionet e Qendres Spitalore Universitare "Nene Tereza", me fond limit total prej: 1,117,059,801 Leke (pa TVSH), me kohezgjatje te kontrates 4 (kater) vite, me Nr. REF-30830-07-18-2019, me date te mbylljes se vleresimit te ofertave 18.09.2019; brenda 7 diteve nga dita kur ankimuesi eshte vene ne dijeni ose duhet te ishte vene ne dijeni mbi vleresimin e ofertes.

Me marrjen e ankeses me shkrim, Organi Qendror Bleres pezulloi vazhdimin e procedures se prokurimit, deri ne marrjen e vendimit perfundimtar sipas parashikimeve ne nenin 63 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik".

Ne mbeshtetje te nenit 63 te ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, pika2, 3. 5 [...] si dhe te VKM nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik " e ndryshuar, neni 78, pika 5 [...] pasi u shqyrtuan te gjitha dokumentat e vena ne dispozicion per kete proedure prokurimi, Ju komunikojme vendimin si me poshte:

Ofertuesi "BOE - Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK" ka ankimuar skualifikimin per mospermbushje te kriterëve te percaktuara ne pikat 1 dhe 2 te seksionit 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar"; pikat 1 dhe 3 te seksionit 3.2 "Kapaciteti Teknik"; kushtin e percaktuar per operatoret ekonomik te huaj sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim dhe kushtin e percaktuar mbi formen e paraqitjes se dokumentave ne tender, sipas Shtojces 8 te dokumentave te tenderit, me pretendimet si vijon:

[...]Ne lidhje me shkaqet (1), (2) dhe (3) te skualifikimit, Kerkesa perkatese ne piken 3 te Shtojces 8, pika 3.1.1, lexon si vijon:

"Operatori ekonomik duhet te paraqese kopje te deklarave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata Tatimore, per xhiron e realizuar ne tre vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.

Per permbushjen e kesaj kerkese, ne kemi depozituar ne SPE, si pjese te ofertes:

Deklaratat e xhiros vjetore per vitin 2016, 2017 dhe 2018 te shoqerise Servizi Italia (Dokumentat e emertuar "S.I 3.1.1 Dichiarazione IVA 2016, "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2017" tlhe "S.I 3.1.1 Dichiarazione IVA 2018") se bashku me perkthimin e noterizuar ne gjuhen shqipe; Proven e depozitimit ne forme elektronike te ketyre deklarave, ne Agjencine e te Ardhurave (Dokumentat e emertuar "S.I 3.1.1 2017 Ricevuta Invio Telematico IVA", "S.I 3.1.1 2018 Ricevuta Invio Telematico IVA" dhe "SI 3.1.1 2019 Ricevuta Invio Telematico IVA"), se bashku me perkthimin e

noterizuar ne gjuhen shqipe; dhe Annex 8 "Auto -Deklarate" leshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj ne lidhje me mundesine dhe formen e leshimit te dokumentave nga shteti Italian. Me paraqitjen e dokumentave te mesiperme ne kemi ofruar prove te plote per permbushjen e kriterit dhe pretendimet e ngritura nga KVO e AK nuk qendrojne per arsytet ne vijim: KVO pretendon se "Dokumenti "Komunikimi i marrjes se deklarates - Modeli i deklarates: TVSH 2018 nuk eshte i njehsuar me origjinalin" e njesoj edhe per dokumentat e viteve te tjera. Sqarojme se dokumenti te cilit i referohet AK. ne origjinalin e vet eshte nje dokument elektronik, me specifikisht nje konfirmim ne forme elektronike i komunikimit elektronik te te dhenave. Kjo provohet nga vetepërmbajtja e Dokumentit referencat ligjore respektive ku percaktohet se: Referenca ligjore e ekzistences se tij eshte neni 3, pg.10 i Dekretit te Presidentit te Republikes nr.322/1999 (.Shtojca3). Me konkretisht kjo dispozite te lexon sa vijon: "Prova e paraqitjes se deklarates realizohet nga mandati I bankes ose te postes ose nepermjet mandatit te dergeses rekomanduar te permendur ne paragrafin 5, ose nga komunikimi i administrates financiare qe verteton manjen e deklarates se paraqitur ne menyre elektronike. ". Vete dokumenti percakton se leshohet sipas Dekretit drejtues (Ministria e Financave) te dates 31/07/1998 "Modalita Technica di trasmissione telematica delle dichiarazioni e dei contratti di locazione e di affitto da sottoporre a registrazione, nonche di esecuzione telematica dei pagamenti" me ndryshimet perkatese (Shtojca 4). Me specifikisht, neni 9; pg. 8 i ketij Dekreti percakton se: "Me perjashtim te rasteve te forces madhore konfirmimet e paraqitjes behen te disponueshme ne menyre elektronike brenda pese diteve te punes nga dergimi i dosjeve te deklarates te cilave u referohen dhe per nje periudhe jo me pak se tridhjetete dite pune". Gjithashtu, operatori ekonomik i huaj Servizi Italia ka deklaruar ne Annex 8 te paraqitur si pjese e dokumentave te ofertes se BOE, se sipas Dekretit Legjislativ 82/2005 "Codice dell'amministrazione digitale" (Shtojca 5), te gjitha dokumentat e prodhuara nga autoritetet publike italiane jane elektronike/dixhitale. Me specifikisht ne nenin 5 bis te ketij ligji, percaktohet se: "Paraqitja e kerkesave, deklaratave, te dhenave dhe shkembimi i informacionit dhe dokumenteve, qofte edhe per qellime statistikore, midis kompanive dhe administratave publike behet ekskluzivisht duke perdorur teknologjite e informacionit dhe komunikimit. Me te njetat metoda administratat publike miratojne dhe komunikojne akte dhe masat administrative ndaj kompanive". Eshte e qarte, se kemi te bejme me nje dokument I cili ne origjinal eshte ne versionin elektronik dhe si I tille eshte depozituar ne SPE. Per efekt te noterizimit te perkthimit dokumenti eshte printuar dhe i eshte bashkelidhur dokumentit te perkthyer ne shqip,/ por ky nuk eshte kopje e origjinalit, por vetetn printim i dokumentit origjinal, i cili eshte depozituar ne SPE, por nuk ka asnje nevojte per njesim me origjinalin, per sa kohe eshte depozituar vete origjinali. KVO pretendon se "Ky dokument nuk eshte I nenshkruar as zyrtarisht (s 'ka emer mbiemer, firme, vule te institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s 'ka vule elektronike /digjitale), si dhe nuk permbun vulen Apostile". Se pari, sic sqaruar edhe me siper, ky dokument nuk mund te jete i nenshkruar si dokumentat zyrtare te prodhuar ne leter, pasi eshte ne vetvete nuk eshte nje akt i mirefillte administrativ. por dokument qe sherben si prove/konferme e komunikimit elektronik. Se dyti, duke mos qene akt administrativ i mirefillte, ky nuk eshte nje dokument nga ato qe kane te detyrueshme pajisjen me vule elektronike/dixhitale, pasi eshte nje dokument dixhital i formes "konferme elektronike", autenticiteti i te cilit, ne perputhje me aktet ligjore italiane te cituara mesiper, sigurohet nepermjet autentifikimit te llogarive te perdoruesve ne secilin prej skajeve te

komunikimit, nga nje ane llogaria e perdoruesit te administrates publike dhe nga ana tjeter, llogaria e certifikuar e perdoruesit nga kompania. Se treti, ne piken 2 te Annex 8 "Auto - Deklarate" (se bashku me shenimet fundore ilustruese), leshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj ne lidhje me mundesine dhe formen e leshimit te dokumentave nga shteti italian, eshte sqaruar se legjislacioni Italian ne fuqi, nuk e lejon mundesine legalizimit apo apostilimit te akteve dhe dokumentave elektronike/dixhitale. KVO pretendon se "... dokumenti i emertuar "Modeli i TVSH 2019 - Periudha talimore 2018 " nuk eshte i nenshkruar nga anetari i BOE-se Servizi Italia SPA 11" Edhe per kete pretendim te KVO, sic sqaruam mesiper, aktet ligjore dhe nenligjore italiane ne fuqi dhe konkretisht Dekreti Legjislativ 82/2005 "Codice dell 'amministrazione digitale" dhe Dekreti drejtues (Ministria e Financave) i dates 31/07/1998, percaktojne nder te tjera qe transmetimi dhe paraqitja e deklarimeve si ai i xhiros, behen nepermjet percjelljes elektronike. Te ketyre deklarimeve nga kompanite, sipas formulareve (moduleve elektronike) te miratuar paraprakisht. duke perdorur llogarite e autentifikuara/certifikuara te perdoruesve. Pra, nuk ka se si te kerkohet qe ky dokument te jete i nenshkruar nga shoqeria Servizi Italia, pasi nenshkrimi qe perdorel zakonisht ne dokumentat ne leter, ne kete rast eshte zevendesuar nga autentifikimi/certifikimi i llogarise se perdoruesit, sipas modaliteteve te percaktuara ne legjislacionin italian ne fuqi. Se fundmi sqarojme se kriteri i vendosur nga AK ne Dokumentat e

Tenderit, ne vetvele kerkon paraqitje te "kopjeve te deklaratave te xhiros vjetore", pa cilesuar ne menyre spcifike qe kerkohet edhe prove dokumentare e depozitimit te ketyre deklaratave. Pra kuptohet lehtesisht qe depozitimi ne SPE nga ana jone i dokumentave "Komunikim i marrjes se deklaratave" eshte nje depozitim fakultativ per te ofruar garanci shtese per AK.

Ne lidhje me shkaqet (4), (5) dhe (6) te skualifikimit Kerkesa perkatese ne piken 3 te Shtojces 8, pika 3.1.1, si vijon: "Operatori ekonomik duhet te paraqese kopje te certifikuara te bilanceve te viteve 2016, 2017, 2018 te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore ",per permbushjen e kesaj kerkese, ne kemi depozituar ne SPE, si pjese te ofertes: Bilancet e shoqerise Servizi Italia per vitet 2016, 2017 dhe 2018 (Dokumentat e emertuar "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2016_EN, "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2017 EN" dhe "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2018_EN") se bashku me perkthimin e noterizuar ne gjuhen shqipe; dhe Proven e depozitimit ne forme elektronike te ketyre Bilanceve (Dokumentat e emertuar "S 3.1.2 FS 2016 official submission", "S 3.1.2 FS 2017 official submission" dhe "S 3.1.2 FS 2018 official submission"), se bashku me perkthimin e noterizuar ne gjuhen shqipe; dhe Annex 8 "Auto - Deklarate" leshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj ne lidhje me mundesine dhe formen e leshimit te dokumentave nga shteti Italian. Me paraqitjen e dokumentave te mesiperme ne kemi ofruar prove te plote per permbushjen e kriterit dhe pretendimet e ngritura nga KVO e AK nuk qendrojne per arsyet ne viim: KVO pretendon se "Dokumentat "Vertetim per paraqitjen ne menyre telematike prane zyres se Regjistrimit te Ndermarrjeve te Parma", te bilancit te anetarit te BOE-se Servizi Italia SPA, nuk permban vulen Apostile" dhe ne vecanti per dokumentin e paraqitjes se bilancit te vitit 2017 se "... nuk eshte i nenshkruar as zyrtarisht (s'ka emer mbiemer, firme. vule institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vule elektronike/digjitale)" Se pari, sic sqaruam edhe me siper. keto dokumenta nuk mund te pajisen me apostile, pasi jane dokumenta te komunikimit elektronik/dixhital. Ne piken 2 te Annex 8 "Auto - Deklorate" (se bashku me shenimet

fundore ilustruese), leshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj ne lidhje me mundesine dhe formen e leshimit te dokumentave nga shteti italian, eshte sqaruar se legjislacioni italian ne fuqi, nuk lejon mundesine e legalizimit apo apostilimit te akteve dhe dokumentave elektronike/dixhitale. Se dyti, ne vetvete keto dokumenta nuk jane akte te mirefillte administrative, por transmetime elektronike qe sherbejne si prove/konferme e komunikimit elektronik; Se treti, duke mos-qene akte administrative te mirefillta, keto nuk jane nga ato dokumente qe e kane te detyrueslune pajisjen me vule elektronike/dixhitale, pasi eshte nje dokument dixhital I formes konferme elektronike ", autenticiteti i te cilit, ne perputhje me aktet llgjore italiane te cituara mesiper, sigurohet nepermjet autentifikimit te llogarive te perdoruesve ne secilin prej skajeve te komunikimit. Edhe kur keto dokumenta kane nenshkrim elektronik kjo eshte fakultative dhe pa ndikim ne vlefshmerine apo autenticitetin e komunikimit, pasi gjendet aty thjesht per arsye te referimit arkivor dixhital. Sqarojme gjithashtu, se keto dokumenta, ne te cilat nenshkrimi elektronik nuk eshte kusht per autenticitetin dhe vlefshmerine. kur printohen apo transmetohen ne llogari te te treteve le paautentifikuara si llogari te certifikuara, mund edhe ta humbin nenshkrimin elektronik te origjines. Se fundmi, sqarojme se kriteri i vendosur nga AK per Dokumentat e Tenderit, ne vetvete kerkon paraqitje te "kopjeve te certifikuara te bilanceve pa cilesuar ne menyre specifike qe kerkohet edhe prove dokumentare e paraqitjes se tyre ne autoritetet tatimore. Sic edhe eshte referuar ne piken 3 te Annex te "Auto-Deklarate" re paraqitur nga operatori ekonomik i huaj, nga ana e ketij OE pjesetar i BOE jane paraqitur te gjitha ato dokumenta te kerkuara per plotesimin e kriterëve ne pikat 3. 1 dhe 3.2 te Shtojces 8 te Dokumentave te Tenderit qe jane te mundshme sipas legjislacionit Italian. Sipas legjislacionit Italian, nuk ekziston nje dokument qe 'provon paraqitjen e bilanceve ne autoritetet tatimore, pasi nuk ekziston nje detyrim ligjor i tille. I vetmi autoritet ne Itali, ku depozitohen bilancet, eshte Cammera Di Commercio (si QKB ne Shqiperi). Pra kuptohet lehtesisht qe depozitimi ne SPE nga ana jone i dokumentave "vertetim per paraqitjen ne menyre telematike prane zyres se Regjistrimit te Ndermanjeve te Parma", 6 eshte nje depozitim fakultativ prej nesh, per te ofruar garanei shtese per AK pervec detyrimit te plotesuar nepermjet Auto- Deklarimit ne Annex 8. KVO pretendon se "Te tre vertetimet per paraqitjen e Bilanceve jane perkthyer nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe, nga perkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtesise, por ne Vertetimin e.firmes se perkthyesit te redaktuar nga noteri publik. nuk rezulton data e leshimit te vertetimit por vetem nr. repertori, si dhe nuk jane te njehsuara me origjinalin"

Se pari, sic kemi sqaruar mesiper. eshte e qarte, se kemi te bejme me dokumenta, ose me sakte komunikime elektronike te te dhenave, te cilat ne origjinal ekzistojn vetem ne versionin elektronik Per efekt te noterizimit te perkthimit., keto dokumenta printohen bashkohen e Lidhen me vulat e noterit me dokumentat e perkthyer ne shqip, si edhe skanohen nga versioni print per tu upload ne SPE, por nuk mund te konsiderohen si kopje te origjinalit, per sa kohe nuk kemi te bejme me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston ne leter. Per me teper, sic edhe sqaruar mesiper keto nuk jane dokumenta te mirefillia por komunikime elektronike te te dhenave, pra nuk ka asnje nevojë per njesim me origjinalin, per sa kohe nuk ekziston nje i tille ne leter.

Se dyti, ne lidhje me pretendimin e KVO se Vertetimet e perkthimit jane te pavlefshme sepse kane vetem. numer repertori dhe jo date, sqarojme se:

Ligji nr. 110, date 20.12.2018 "Per Noterine". ne nenin 3 germa "e", nenet 62, 63, 97, 106 dhe ne Kreun III te ligjit, percakton ne menyre te qarte aktet noteriale si te dallueshme nga veprimet noteriale. Gjithashtu, eshte e qarte se Ligji ne fjale, por edhe Udhezimi i Ministrise se Drejtesise Nr. 6291, date 17.08.2005 "Per evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e te dokumenteve noteriale, si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale i cituar nga KVO, "Vertetimin e perkthimit" e percakton si "veprim noterial dhe jo si "akt noterial". Neni 105 i Ligjit Nr. 110, date 20.12.2018 "Per Noterine", te cilit i referohet KVO, ben fjale per detyrueshem te aktit noterial" dhe kio del qarte duke filluar qe nga titulli i nenit dhe metej nga permbajtja e tij, ku specifikisht i referohet "aktit noterial" pa perfshire "veprimin notarial". Nga ana tjeter edhe neni 135 te cilit i referohet KVO, qe rregullon veprimin noterial te "vertetim te perkthimeve" nuk ben fjale per daten si element te detyrueshem. KVO e AK, ne menyre teresisht te kundraligjshme, deklararon se vertetimet e perkthimeve ne fjale konsiderohen "te pavlefshme".

Kjo per dy arsye: (i) sepse sipas nenit 137 te Ligjit Nr.110, date 20.12.2018 "Per Noterine", jane percaktuar qarte rastet e pavlefshmerise se aktit noterial dhe veprimit noterial, dhe mungesa e dates (germa "d" dhe "e" e nenit) e percaktojne mungesen e dates si element pavlefshmerie vetem per aktin noterial dhe jo edhe per veprimin noterial; dhe (ii) sipas nenit 138 te Ligjit Nr.110. date 20.12.2018 "Per Noterine". rezulton qarte se akti ose veprimi noterial deklarohen te pavlefshem vetem nga Gjykata pas; kjo eshte vene ne levizje nga personal e treguar ne kete nen. Pra KVO nuk ka asnje tager te deklaroje pavlefshmerine e ketyre veprimeve noteriale. Se fundmi per te qartesuar me mire kete qendrim te kundraligjshem te KVO, po paraqesim bashkelidhur kesaj Ankese Shtojcen 6, nepermjet te ciles korfirmohet edhe njehere nga noteri rregullshmeria e vertetimeve te perkthimit te bera prej saj, te depozituara ne kete procedure.

Ne lidhje me shkakun (7) te skualifikimit: KVO pretendon se "Dokumenti "Korfirmim i xhiros" i paraqitur per te provuar sherbime te ngjashme te meparshme per periudhen 2016, 2017, 2018 te anetarit te BOE-se Servizi Italia SPA, leshuar me date 20.06.2019 nga institucioni Sherbimi Shendetesor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali. nuk permбан Vulen Apostile". Sic e kemi sqaruar edhe mesiper, ky dokument i leshuar nga nje autoritet publik, eshte nje dokument dixhital i leshuar me nenshkrim elektronik. Kete fakt e kemi provuar edhe nepermjet depozitimit ne SPE te dokumentit te emertuar "SI 3.2.1 verifica firma digitale attestazione Ist Rizzoli". Ne piken 2 te Annex 8 "Auto - Deklarate" (se bashku me shenimet fundore ilustruese), leshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj ne lidhje me mundesine dhe formen e leshimit te dokumentave nga shteti italian, eshte sqaruar se legjislacioni italian ne fuqi, nuk lejon mundesine e legalizimit apo apostilimit te akteve dhe dokumentave elektronike/dixhitale. KVO pretendon se "ky dokument eshte perkthyer nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe, nga perkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtesise, por ne Vertetimin e firmes se perkthyesit te redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e leshimit te vertetimit por vetem nr. repertori, si dhe nuk eshte i njehsuar me origjinalin." Se pari, sie kemi sqaruar mesiper, eshte e qarte, se kemi te bejme me dokumenta dixhitale te nenshkruar elektronikisht.

Per efekt te noterizimit te perkthimit, keto dokumenta printohen bashkohen e lidhen me vulat e noterit me dokumentat e perkthyer ne shqip, si edhe skanohen nga versioni print per tu upload ne SPE, por nuk mund te konsiderohen si kopje te origjinalit, per sa kohe nuk kemi te bejme me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston ne leter.

Pra nuk ka asnje nevojë për njësimi me origjinalin, për sa kohë, nuk ekziston një i tillë në leter por vetëm dokumenti dixhital/elektronik. Se dyti, në lidhje me pretendimin e KVO së Vertetimet e përkthimit janë të pavlefshme, e kemi sqaruar kundërshtimin me argumentat në pikën II.b mesipër në këtë ankese.

Në lidhje me shkaqet (8) dhe (9) të skualifikimit Për sa i përket shkakut (8) të skualifikimit për të evituar rënien në përsëritje ju referojmë sqarimin e kundërshtimit tonë me argumentat në pikën II.b mësipër në këtë ankese. Për sa i përket shkakut (9) të skualifikimit për të evituar rënien në përsëritje ju referojmë në sqarimin e kundërshtimit tone me argumentat në pikën I.b dhe II.a mesipër në këtë ankese.

Në përfundim, duam të theksojmë se, ne kemi ofruar në këtë procedurë vlerën ekonomikisht më të favorshme me një diferencë prej rreth 98 milion lekë ose 820.000 Euro, dhe për më tepër anëtari i BOE Servizi Italia s.p.a është kompania lider në Itali dhe me përmasa e shtrirje të sukseshme ndërkombëtare për ofrimin e këtij shërbimi. Kjo do të thotë, se çdo artific i krijuar për skualifikim të sforcuar të ofertës sonë, nëse do të synohej në lidhjen e kontratës me vlerë më të madhe do, jo vetëm do të shkakonte dëm ekonomik për buxhetin, por edhe do të çenonte rëndë interesin publik, duke mohuar ofrimin e shërbimit nga një operator me kredenciale të forta dhe histori suksesi ndërkombëtare.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentat e tenderit, vleresimin e bere në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit të Ofertave, dokumentat e dorëzuara nga ofertuesi "BOE - Servizi Italia SPA+ Sanitary Cleaning SHPK", si dhe pretendimet e parashtruara në ankese mbi skualifikimin e ofertes së tij, konstaton si më poshtë:

Për ofertuesin "BOE - Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK", Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka dhënë dhe njoftuar automatikisht nepermjet sistemit të prokurimit elektronik me datë 18.09.2019, arsyet e skualifikimit si vijon:

"Dokumenti" Komunikim i marrjes së deklaratës Modeli i deklaratës: TVSH 2018" i leshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 19042917243251703, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin.

Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emer, mbiemer, firme, vule të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s'ka vule elektronike/digitale), si dhe nuk përmban Vulen Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA. - Dokumenti i "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2017" i leshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të ardhurave", me nr.protokolli 34, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin.

Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emer mbiemer, firme, vule institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vule elektronike/ dixhitale), si dhe nuk përmban Vulen Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3. I "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e

percaktuar per operatoret ekonomik te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim Shtojca 8 e DT Gjithashtu, dokumenti i emertuar "Modeli i TVSH 2018 - Periudha tatimore 2017" nuk eshte i nenshkruar nga anetari i BOE-se Servizi Italia SPA.

- Dokumenti "Komunikim i marrjes se deklarates ~ Modeli i deklarates: TVSH 2016" i leshuar nga administrata talimore e shtetit Italian "Agjencia e te Ardhurave", me nr.protokolli 17022812551019395, eshte i perkthyer nga perkthyes zyrtar nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe por nuk eshte i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk eshte i nenshkruar as zyrtarisht (s'ka emer mbiemer, firme, vule institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vule elektronike/dixhitale si dhe nuk permban Vulen Apostile, duke mos plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e percaktuar per operatoret ekonomike te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emeruar "Modeli i TVSH 2017 - Periudha tatimore 2016, nuk eshte i nenshkruar nga anetari; BOE-se Serviz Italia SPA. - Dokumenti "Vertetim per paraqitjen ne menyre telematike prane zyres se Regjistrimit te ndermarrjeve te Parma", te bilancit per vitin 2016 te anetarit te BOE-se Servizi Italia SPA. me Nr.PRA/1509/201 7/CPRAUTO date 12.05.2017, leshuar nga inslitucioni Dhoma e Tregtise Parma, Itali, nuk permban vulen Apostile, duke mos plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar si dhe kushtin e percaktuar per operatoret ekonomik te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim Shtojca 8 e DT - Dokumenti "Vertetim per paraqitjen ne menyre telematike prane zyres se Regjistrimit te Ndermarrjeve te Parma", te bilancit per vitin 2017 te anetam te BOE-se Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/ 12732/2018/CPRAUTO, date" 14.05.2018, leshuar nga istitucioni Dhoma e Tregtise Parma, Itali, nuk eshte i nenshkruar as zyrtarisht (s'ka emier mbiemer, firme, vule institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vule elektronike/dixhilale), si dhe nuk permhrm vulen apostile, duke mos plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 3.1 (2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar si dhe kushtin e percaktuar per operatoret ekonomik te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim Shtojca 8 e DT.

- Dokumenti "Vertetim per paraqitjen ne menyre telematike prane zyres se Regjistrimit te Ndermarrjeve te Parma", te bilancit per vitin 2018 te anetarit te BOE-se Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/210570/2019/CPRAUTO, date 19.06.2019; leshuar Aga_Mmstitucioni Dhoma e Tregtise Parma, Itali, nuk permban vulen Apostile, duke mos plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 3.1 (2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e percaktuar per operatoret ekonomik te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim Shtojca 8 e DT. Te tre vertetimet per paraqitjen e bilanceve jane perkthyer nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe, nga perkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtesise, por ne Vertetimin e firmes se perkthyesit te redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e leshimit te vertetimit por vetem nr.repertorit, si dhe nuk jane te njehsuara me origjinalin. Ky vertetim eshte i pavlefshem, pasi bie ne kundershkim me Ligjin per Noterine Nr. 110, date 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 te tij dhe Udhezimin e Ministrise se Drejtesise Nr.6291, date 17.08.2005 "Per evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e te dokumenteve noteriale, si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij. - Dokumenti "Konfirmim i xhiros" i paraqitur per te provuar sherbime te ngjashme te meparshnte per periudhen 2016, 2017, 2018 te anetarit te BOE-se Servizi Italia SPA, leshuar me date 20.06.2019 nga Institucioni Sherbimi Shendetesor Rajonal Emilia Romagna - Instituti

Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk permban Vulen Apostile, duke mos plotesuar kriterin e percaktuar ne piken 3.2(1) "Kapaciteti teknik" si dhe kushtin e percaktuar per operatoret ekonomik te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim Shtojca 8 e DT.

Ky dokument ishte perkthyer nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe, nga perkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtesise, por ne Vertetimin e firmes se perkthyesit te redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e leshimit te vertetimit por vetem nr.repertori, si dhe nuk eshte i njehsuar me origjinalin. Ky vertetim eshte i pavlefshem pasi bie ne kundershtrim me Ligjin per Noterine Nr.110. date 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 te tij dhe Udhezimin e Ministrise se Drejtesise Nr. 6291, date 17.08.2005 "Per evidentimin. administrimin dhe ruajtjen e akteve e te dokumenteve noteriale, si dhe per organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale". pika 2 dhe 3 e tij. I gjithë dokumentacioni i vetedeklaruar ne institucionin Italian INAIL, i paraqitur ne tender nga anetar i BOE-se Servizi Italia , per te provuar pasjen e fuqise punetore, eshte perkthyer nga gjuha italiane ne gjuhen shqipe, nga perkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtesise, por ne Vertetimin e firmes se perkthyesit te redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e leshimit te vertetimit por vetem nr.repertorit si dhe nuk jane te njehsuar me origjinalin. Ky vertetim eshte i pavlefshem pasi bie ne kundershtrim me Ligjin per Noterine Nr. 110, date 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 te tij dhe Udhezimin e Minis/risese Drejtesise Nr. 6291. datel 7. 08.2005 "Per evidentimin, administrimin dhe ruajtjen akteve e te dokumenteve noteriale, si dhe per organizimin dhe ruajtjen arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij. - Dokumentacioni "Njoftim i detyrueshem" i Administrates se Provinces Parma - Sherbimi i Formimit Profesional dhe Politikave Aktive te Punes, nuk permban Vulen Apostile, duke mos plotesuar kushtin e percaktuar per operatoret ekonomike te huaj, sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta Shtojca 8 e DT. Per rrjedhim, ofertuesi BOE – Servizi Italia SPA + Sanitari Cleaning SHPK, nuk arriti te provoje permbushjen e kriterit te percaktuar ne piken 2.3 (3) te kapacitetit teknik te dokumentave te tenderit, per fuqine punetore." Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave verifikoi dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ne sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi BOE - "Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK" dhe konstatoi se disa nga dokumentat e paraqitur per te provuar kualifikimet e anetarit te BOE-se "Servizi Italia SPA" (kompani e rregjistruar dhe me aktivitet ne shtetin italian), nuk jane ne perputhje me kriteret dhe kerkesat e percaktuara ne pikat I dhe 2 te seksionit 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar"; pikat 1 dhe 3 te seksionit 3.2 "Kapaciteti Teknik"; kushtin e percaktuar per operatoret ekonomik te huaj sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim dhe kushtin e percaktuar mbi formen e paraqitjes se dokumentave ne tender, sipas Shtojces 8 te dokumentave te tenderit.

Se pari: Kushti i pjesemarrjes ne proceduren e prokurimit per operatoret ekonomik te huaj qe kane regjistrim ne shtetet anetare te Konventes se Hages (5 TETOR 1961), sic eshte edhe Italia, eshte qe dokumentet e leshuara duhet te permbajne vulen apostile ne perputhje me ligjin nr. 9060, date 8.5.2003 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne Konventen per heqjen e kerkeses per legalizimin e dokumenteve zyrtare te huaja". Shqiperia dhe Italia jane vende anetare (qe kane ratifikuar/aderuar) te Konventes se Hages "Per heqjen e detyrimit te legalizimit te dokumenteve zyrtare te huaja" te 5 tetorit 1961, e per rrjedhim dokumentet e leshuara nga institucionet shqiptare qe do te perdoren ne vendet anetare te se njejtës Konvente, si dhe anasjelltas, nuk do te legalizohen nga perfaqesite diplomatike e konsullore.

Ne baze te kesaj Konvente, dokumentet pajisen me nje vule Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku jane leshuar dokumentat (ne rastin konkret Italia), elhe me pas mund te perdoren direkt ne institucionin perkates te vendit prites (ne rastin konkret Shqiperia).

Prandaj dokumentet qe origjinojne nga Italia, duhet te apostilohen para se te paraqiten prane autoriteteve shqiptare. Autoritetet pergjegjese per apostilimin e dokumenteve, ku përfshihet dhe shteti Italian, gjenden ne adresen:

http://www.hcch.net/indeex_en.php?aet=conventions.authorities&cid=41.

Anetari i BOE-se "Servizi Italia SPA" duhet te kishte ndjekur procedurat prane autoriteteve kompetente italiane per pajisjen me vule Apostile te dokumentacionit zyrtar te leshuar nga institucionet italiane, perpara se ta paraqiste ate si pjese te ofertes ne proceduren e prokurimit (ne nje vend te huaj).

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga anetari i BOE-se "Servizi Italia SPA" per te provuar plotesimin e kriterëve dhe kerkesave te percaktuara ne pikat 1 dhe 2 te seksionit 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar"; pikat 1 dhe 3 te seksionit 3.2 "Kapaciteti Teknik", si dhe kushtin e percaktuar per operatorët ekonomik te huaj sipas paragrafit te parafundit te kriterëve te vecanta per kualifikim, te percaktuara ne Shtojcen 8 te dokumentave te tenderit, nuk rezulton te jete ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi dhe as me kushtet e percaktuara ne dokumentat e tenderit.

Se dyti: Kushti i pjesemarrjes ne proceduren e prokurimit per te gjithë operatorët ekonomik eshte qe te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuar te tyre, dhe se rastet e mos dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim. Sjellim ne vemendje se dokumentacioni i paraqitur nga anetari i BOE-se "Servizi Italia SPA" per te provuar plotesimin e kriterëve dhe kerkesave te percaktuara ne pikat 1 dhe 2 te seksionit 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar"; pikat 1 dhe 3 te seksionit 3.2 "Kapaciteti Teknik", si dhe kushtin e percaktuar mbi formen e paraqitjes se dokumentave sipas Shtojces 8 te dokumentave te tenderit, nuk rezulton te jene ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi dhe as me kushtet e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Me konkretisht, rezulton se keto dokumenta nuk jane hartuar ne perputhje me Ligjin nr.110/2018 "Per Noterine" (si dhe aktet nenligjore te data ne zbatim te tij), ku parashikohet se:

-neni 99 "Menyra e hartimit te akteve noteriale", pika 1, ku parashikohet se: "Aktet noteriale hartohen ne haze te vullnetit te lire, te plote dhe te pavesuar te paleve pjesemarrrese ne aktin noterial,si dhe referuar qellimit qe synon te rreulloje dhe/ose te sjelle akt noterial. Aktet noteriale hartohen paster, qarte dhe ne menyre qe te mos lene vend per moskuptime ose keqinterpretime."

-neni 105 "Permbajtja e aktit notarial", pika 2, ku parashikohet se: "Akti noterial permhan: a) numrin e repertorit dhe te koleksionil, identifikuesin elektronik te aktit, vendin e hartimit te aktit; b) ditën, muajin dhe vitin e hartimit. llojin e aktit, dhe, kur eshte rasti, oren dhe minuten e fillimit dhe ate te mbarimit te aktit; ... " ;

-neni 129 "Vertetimi i njesise me origjinalin", pika 1 dhe pika 5, ku parashikohet se: "Noteri ben vertetimin e njesise se kopjeve ose te shkrimeve te dokumenteve me origjinalin, te dokumenteve te publikuara, si dhe te cdo dokumenti tjeter, pasi te kete krahasuar permbajtjen e tyre

5. Ne rastin kur dokumentacioni eshte ne gjuhe te huaj noteri ben vertetimin e njesise me origjinalin, duke kerkuar ndihmen e nje perkthyesi, ose duke e bere vete konkretisht, sipas parashikimeve te nenit 100 te ketij ligji.",

-Neni 135 "Vertetimi i perkthimeve" ku parashikohet se: "Perkthimi i nje dokumenti nga nje gjuhe e huaj ne gjuhen shqipe dhe anasjelltas behet nga vete noteri, ne gjuhen per te cilen eshte i perfshire ne listen e perkthyesve zyrtare te administruar nga Ministria e Drejtesise. Per gjuhe te tjera, qe noteri nuk i zoteron, perkthimi behet nga perkthyes te perfshire ne listen e perkthyesve zyrtare per

dokumente zyrtare dhe nga persona te tjere per dokumente te nje natyre tjeter. Ne rastet e perkthimeve te bera nga perkthyes ose persona te tjere te pranuar nga palet, noteri pasqyron ne akt identitetin e perkthyesit, njesoj si per palet. Perkthimi shkruhet ne fund ose perbri dokumentit dhe nenshkruhet perkatesisht nga noteri, sipas ligjit ose nga perkthyesi."

-neni 137 "Aktet dhe veprimet noteriale te pavlefshme", ku parashikohet shprehimisht se: "Veprimet dhe aktet noteriale jane te pavlefshme ne te gjitha rastet kur pavlefshmeria parashikohet shprehimisht ne ligj, ose eshte nje sanksion i nevojshem, sipas qellimit te ligjit, vecanerisht ne rastet ne vijim, por pa u kufizuar ne to: a) kryerja e tyre eshte ne kompetencen e nje organi tjeter shteteror; b) ne aktin ose ne veprimin noterial kane marre pjese personal qe tregohen ne nenin 98 te ketij ligji; e) akti noterial permban disponim ne dobi te personave, per te eilet parashikohen ndalime sipas nenit 98 te ketij ligji c) akti noterial ose vertetimi i nenshkrimeve nuk jane nenshkruar personalisht nga palet ose perfaqesuesit e tyre te autorizuar: ti) ne aktin noterial nuk tregohet identiteti i paleve, data dhe vendi ku eshte bere; dh) akti ose veprimi noterial nuk permban nenshkrimin e paleve ose nuk eshte nenshkruar dhe vulosur me te dyja vulat nga noteri; e) akti noterial eshte hartuar pa u respektuar rregullat e parashikuara ne piken 2, te nenit 105, te ketij ligji."

Persa me siper, rezulton se nuk qendrojne pretendimet dhe argumentat e paraqitura ne ankese, ne lidhje me skualifikimin per shkak te paraqitjes se dokumentave ne gjuhe te huaj te perkthyer ne gjuhen shqipe, te shoqeruara me vertetime perkthimi te cilat nuk permbajne ditën, muajin dhe vitin e hartimit te aktit, si dhe dokumenta te cilat nuk jane te njesuara me origjinalin.

Gjithashtu, sjellim ne vemendje se dokumentacioni i paraqitur nga anetari i BOE-se "Servizi Italia SPA" per te provuar plotesimin e kriterëve dhe kerkesave te percaktuara ne pikat 1 dhe 2 te seksionit 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar"; pikat 1 dhe 3 te seksionit 3.2 "Kapaciteti Teknik", si dhe kushtin e percaktuar mbi formen e paraqitjes se dokumentave sipas Shtojces 8 te dokumentave te tenderit, nuk rezulton te jene ne perputhje me parashikimet ligjore ne fuqi dhe as me kushtet e percaktuara ne dokumentat e tenderit, sepse dokumentet nuk jane te nenshkruara as zyrtarisht (s'kane emer mbiemer, firme, vule te institucionit qe i ka leshuar ne shtetin italian) dhe as elektronikisht (s'kane vule elektronike/dixhitale). Kushti i pjesemanjes ne proceduren e prokurimit per te gjithë operatorët ekonomik eshte qe te gjithë dokumentat duhet te jene origjinale ose kopje te noterizuara te tyre, dhe se rastet e mos-dorezimit te nje dokumenti, ose te dokumentave te rreme e te pasakta, konsiderohen si kushte per skualifikim.

Persa me siper, nese ofertuesi do te kishte paqartesi per dokumentet e tenderit, mund te kishte kerkuar shpjegime/ sqarime bazuar ne nenin 42, pika 1, Ligji nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" i ndryshuar, ku parashikohet se:

"Ofertuesi i mundshem mund te kerkoje sqarime per dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t 'i pergjigjet cdo kerkese per sqarim te dokumenteve te tenderit, te bere nga cdo operator ekonomik, me kusht qe kerkesa te jete marre jo me vone se 5 dite para afatit perfundimtar te dorezimit te ofertave. Autoriteti kontraktor duhet te pergjigjet brenda 3 diteve nga depozitimi i kerkeses ne menyre qe te beje te mundur dorezimin e ofertes ne kohe nga operatori ekonomik dhe pa identifikuar burimin e kerkeses, duhet t 'ia komunikojte sqarimin perkates te gjithe operatoreve ekonomike, qe kane terhequr dokumenret e tenderi."

Po ashtu, nese ofertuesi do te kishte kundeshitim per kriteret kualifikuese ose kerkesat e specifikimeve teknike, duhet te kishte paraqitur ankesa brenda 7 (shtate) diteve nga publikimi i procedures, bazuar ne piken 1.1 te nenit 63 te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 ".Per prokurimin publik" i ndryshuar, ku parashikohet se: "Ne rastin e ankesave per dokumentet e tenderit, operatoret ekonomike mund te ankohen prane autoritetit kontraktor brenda 7 diteve nga data e publikimit te njoftimit te kontrates ne faqen zyrtare te Agjencise se Prokurimit Publik",

Per rrjedhim, ne fazen e vleresimit te ofertave Komisioni i Vleresimit te Ofertave shqyrton dhe vlereson dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesi vetem mbi kushtet dhe kriteret e percaktuara ne dokumentat e tenderit. Prandaj, mosplotesimi qofte edhe i nje kriteri te vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e ben oferten e operatorit ekonomik te pavlefshme. Ofertuesi ankimues duhej te dorezonte te gjithe dokumentacionin e kerkuar ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, n~ slstemin elektronik te prokurimeve. Operatori ekonomik eshte i detyruar te pergatise oferten, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit, ne menyre qe edhe vleresimi te behet ne perputhje me keto kerkesa. Dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi ne proceduren e prokurimit, nuk ploteson kushtet dhe kerkesat e autoritetit kontraktor, e si i tille nuk mundte konsiderohet i vlefshem.

Per arsyet e mesiperme, pretendimet e paraqitura ne ankesen e ofertuesit bashkimi i operatoreve ekonomik "Servizi Italia SPA+ Sanitary Cleaning SHPK", nuk pranohen.

Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP.

II.6. Në datën 11.10.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, konkretisht si më poshtë vijon:

[...]

Më datë 03.09.2019, kemi paraqitur ofertën tonë si BOE Servizi Italia SPA & Sanitary Cleaning shpk, duke ofruar cmim ekonomik mjaft të favorshëm dhe të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga AK.

Më datë 18.09.2019, u njoftuam në SPE për rezultatet e vlerësimit të ofertave nga KVO si vijon:

<i>Operatoret Ekonomike</i>	<i>Vlera e ofertuar</i>	<i>Refuzuar</i>
<i>BOE SANITARY CLEANING</i>	<i>1012676242.50</i>	<i>Po</i>
<i>AGS</i>	<i>1111482284.50</i>	<i>Po</i>
<i>DEVIS</i>	<i>1117059793.00</i>	<i>Po</i>

Në po të njejtën datë në SPE janë njoftuar dhe arsyet e refuzimit të ofertës sonë, dhe konkretisht KVO shprehet: "Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 19042917243251703, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

2. Dokumenti i "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2017" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 18043013003466134, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2018 - Periudha tatimore 2017" nuk është i nënshkruar nga anëtar i i BOE-së Servizi Italia SPA.

3. Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2016" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 17022812551019395, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2017 - Periudha tatimore 2016" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

4. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2016 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr.PRA/1509/2017/CPRAUTO datë 12.05.2017, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

5. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2017 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr.PRA/12732/2018/CPRAUTO, datë 14.05.2018, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe

as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT

6. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/210570/2019/CPRAUTO, datë 19.06.2019; lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Të tre vërtetimet për paraqitjen e Bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm, pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

7. Dokumenti "Konfirmim i xhiros" i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019 nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.2(1) "Kapaciteti teknik" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

8. I gjithë dokumentacioni i vetdeklaruar në institucionin italian INAIL, i paraqitur ne tender nga anëtar i i BOE-së Servizi Italia SPA, për të provuar pasjen e fuqisë punëtore, është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noter i publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij

9. Dokumentacioni "Njoftim i detyrueshëm" i Administratës së Provincës Parma - Shërbimi i Formimit Profesional dhe Politikave Aktive të Punës, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos

plotësuar kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Për rrjedhim, ofertuesi BOE - Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK nuk arriti të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3 (3) të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, për fuqinë punëtore

Shkaqet e mësipërme për skualifikimin tonë, i kundërshtojmë si vijon:

I. Në lidhje me shkaqet (1), (2) dhe (3) të skualifikimit

Kërkesa përkatëse në pikën 3 të Shtojcës 8, pika 3.1.1, lexon si vijon: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit"

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, ne kemi depozituar në SPE, si pjesë të ofertës:

(i) Deklaratat e xhiros vjetore për vitin 2016, 2017 dhe 2018 të shoqërisë Servizi Italia (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2016", "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2017" dhe "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2018") së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

(ii) Provën e depozitimit në formë elektronike të këtyre Deklaratave, në Agjencinë e të Ardhurave (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.1 2017 Ricevuta Invio Telematico IVA", "SI 3.1.1 2018 Ricevuta Invio Telematico IVA" dhe "SI 3.1.1 2019 Ricevuta Invio Telematico_IVA"), së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe; dhe

(iii) Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

Me paraqitjen e dokumentave të mësipërme ne kemi ofruar provë të plotë për përmbushjen e kriterit dhe pretendimet e ngritura nga KVO e AK nuk qëndrojnë për arsytet në vijim:

a. KVO pretendon se "Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018" nuk është i njehsuar me origjinalin" e njësoj edhe për dokumentat e viteve të tjera.

Sqarojmë se dokumenti të cilit i referohet AK, në origjinalin e vet është një dokument elektronik, me specifikisht një konfirmim në formë elektronike i komunikimit elektronik të të dhënave. Kjo provohet nga vetë përmbajtja e dokumentit referencat ligjore respektive ku përcaktohet se:

- Referenca ligjore e ekzistencës së tij është neni 3, pg.10 i Dekretit të Presidentit të Republikës nr.322/1999 (Shtojca 3). Më konkretisht kjo dispozitë lexon sa vijon: "Prova e paraqitjes së deklaratës realizohet nga mandati i bankës ose të postës ose nëpërmjet mandatit të dërgesës rekomande të përmendur në paragrafin 5, ose nga komunikimi i administratës financiare që vërteton marrjen e deklaratës së paraqitur në mënyrë elektronike".
- Vetë dokumenti përcakton se lëshohet sipas Dekretit drejtues (Ministria e Financave) të datës 31/07/1998 "Modalita' tecniche di trasmissione telematica delle dichiarazioni e dei contratti di locazione e di affitto da sottoporre a registrazione, nonche' di esecuzione telematica dei pagamenti" me ndryshimet përkatëse (Shtojca 4). Më specifikisht, neni 9, pg. 8 i këtij Dekreti përcakton se: "Me përjashtim të rasteve të forcës madhore, konfirmimet e paraqitjes bëhen të disponueshme në mënyrë elektronike brenda pesë ditëve të punës nga

dërgimi i dosjeve të deklaratës të cilave u referohen dhe për një periudhë jo më pak se tridhjetë ditë pune".

- Gjithashtu, operatori ekonomik i huaj Servizi Italia ka deklaruar në Annex 8 të paraqitur si pjesë e dokumentave të ofertës së BOE, se sipas Dekretit Legjislativ 82/2005 "Codice dell'amministrazione digitale" (Shtojca 5), të gjitha dokumentat e prodhuara nga autoritetet publike italiane janë elektronike/dixhitale. Më specifikisht në nenin 5 bis të këtij ligji, përcaktohet se: "Paraqitja e kërkesave, deklaratave, të dhënave dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve, qoftë edhe për qëllime statistikore, midis kompanive dhe administratave publike bëhet ekskluzivisht duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Me të njëjtat metoda administratat publike miratojnë dhe komunikojnë akte dhe masat administrative ndaj kompanive".

Është e qartë, se kemi të bëjmë me një dokument i cili në origjinal është në versionin elektronik dhe si i tillë është depozituar në SPE. Për efekt të noterizimit të përkthimit, dokumenti është printuar dhe i është bashkëlidhur dokumentit të përkthyer në shqip, por ky nuk është kopje e origjinalit, por vetëm printim i dokumentit origjinal, i cili është depozituar vecan në SPE, pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë është depozituar vetë origjinali.

b. KVO pretendon se "Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile".

Së pari, sic sqaruar edhe më sipër, ky dokument nuk mund të jetë i nënshkruar si dokumentat zyrtarë të prodhuar në letër, pasi është në vetvete nuk është një akt i mirëfilltë administrativ, por dokument që shërben si provë/konfermë e komunikimit elektronik.

Së dyti, duke mos qenë akt administrativ i mirëfilltë, ky nuk është një dokument nga ato që ka të detyrueshme pajisjen me vulë elektronike/dixhitale, pasi është një dokument dixhital i formës "konfermë elektronike", autenticiteti i të cilit, në përputhje me aktet ligjore italiane të cituara më sipër, sigurohet nëpërmjet autentifikimit të llogarive të përdoruesve në secilin prej skajeve të komunikimit, nga një anë llogaria e përdoruesit të administratës publike dhe nga ana tjetër, llogaria e certifikuar e përdoruesit nga kompania.

Së treti, në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitale.

c. KVO pretendon se "... dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA".

Edhe për këtë pretendim të KVO, sic sqaruar më sipër, aktet ligjore dhe nënligjore italiane në fuqi dhe konkretisht Dekreti Legjislativ 82/2005 "Codice dell'amministrazione digitale" dhe Dekreti drejtues (Ministria e Financave) i datës 31/07/1998, përcaktojnë ndër të tjera që transmetimi dhe paraqitja e deklarimeve si ai i xhiros, bëhen nëpërmjet përcjelljes elektronike të këtyre deklarimeve nga kompanitë, sipas formularëve (moduleve elektronikë) të miratuar paraprakisht, duke përdorur llogaritë e autentifikuara/certifikuara të përdoruesve.

Pra, nuk ka se si të kërkohet që ky dokument të jetë i nënshkruar nga shoqëria Servizi Italia, pasi nënshkrimi që përdoret zakonisht në dokumentat në letër, në këtë rast është zëvendësuar nga autentifikimi/certifikimi i llogarisë së përdoruesit, sipas modaliteteve të përcaktuara në legjislacionin italian në fuqi.

d. Së fundmi sqarojmë se kriteri i vendosur nga AK në Dokumentat e Tenderit, në vetvete kërkon paraqitje të "kopjeve të deklaratave të xhiros vjetore", pa cilësuar në mënyrë specifike që kërkohet edhe provë dokumentare e depozitimit të këtyre deklaratave. Pra kuptohet lehtësisht që depozitimi në SPE nga ana jonë i dokumentave "Komunikim i marrjes së deklaratës" është një depozitim fakultativ për të ofruar garanci shtesë për AK.

Pra, shkaqet e skualifikimit (1), (2) dhe (3) nuk qëndrojnë.

II. Në lidhje me shkaqet (4), (5) dhe (6) të skualifikimit

Kërkesa përkatëse në pikën 3 të Shtojcës 8, pika 3.1.1, lexon si vijon: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore".

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, ne kemi depozituar në SPE, si pjesë të ofertës:

(i) Bilancet e shoqërisë Servizi Italia për vitet 2016, 2017 dhe 2018 (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2016_EN", "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2017 EN" dhe "SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2018_EN") së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

(ii) Provën e depozitimit në formë elektronike të këtyre Bilanceve (Dokumentat e emërtuar "SI 3.1.2 FS 2016 official submission", "SI 3.1.2 FS 2017 official submission" dhe "SI 3.1.2 FS 2018 official submission"), së bashku me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe; dhe

(iii) Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

Me paraqitjen e dokumentave të mësipërme ne kemi ofruar provë të plotë për përmbushjen e kriterit dhe pretendimet e ngritura nga KVO e AK nuk qëndrojnë për arsyet në vijim:

a. KVO pretendon se "Dokumentat "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, nuk përmban vulën Apostile" dhe në vecanti për dokumentin e paraqitjes së bilancit të vitit 2017 se "... nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digitale)".

Së pari, sic sqaruam edhe më sipër, këto dokumenta nuk mund të pajisen me apostile, pasi janë dokumenta të komunikimit elektronik/dixhital. Në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitalë.

Së dyti, në vetvete këto dokumenta nuk janë akte të mirëfilltë administrative, por transmetime elektronike që shërbejnë si provë/konfirmë e komunikimit elektronik.

Së treti, duke mos qenë akte administrative të mirëfillta, këto nuk janë nga ato dokumente që e kanë të detyrueshme pajisjen me vulë elektronike/dixhitale, pasi është një dokument dixhital i formës "konfirmë elektronike", autenticiteti i të cilit, në përputhje me aktet ligjore italiane të cituara më sipër, sigurohet nëpërmjet autentifikimit të llogarive të përdoruesve në seicilin prej skajeve të komunikimit. Edhe kur këto dokumenta kanë nënshkrim elektronik kjo është fakultative dhe pa ndikim në vlefshmërinë apo autenticitetin e komunikimit, pasi gjendet aty thjesht për arsye të referimit arkivor dixhital. Sqarojmë gjithashtu, se këto dokumenta, në të cilat nënshkrimi elektronik nuk është kusht për autenticitetin dhe vlefshmërinë, kur printohen apo transmetohen në llogari të të tretëve të paautentifikuara si llogari të certifikuar, mund edhe ta humbin nënshkrimin elektronik të origjinës.

Së fundmi, sqarojmë se kriteri i vendosur nga AK në Dokumentat e Tenderit, në vetvete kërkon paraqitje të "kopjeve të certifikuar të bilanceve", pa cilësuar në mënyrë specifike që kërkohet edhe provë dokumentare e paraqitjes së tyre në autoritetet tatimore. Sic edhe është referuar në pikën 3 të Annex të "Auto-Deklaratë" të paraqitur nga operatori ekonomik i huaj, nga ana e këtij OE pjesëtar i BOE janë paraqitur të gjitha ato dokumenta të kërkuara për plotësimin e kriterëve në pikat 3.1 dhe 3.2 të Shtojcës 8 të Dokumentave të Tenderit që janë të mundshme sipas legjislacionit Italian. Sipas legjislacionit italian, nuk ekziston një dokument që provon paraqitjen e bilanceve në autoritetet tatimore, pasi nuk ekziston një detyrim ligjor i tillë. I vetmi autoritet në Itali, ku depozitohen bilancet, është Cammera Di Commercio (si QKB në Shqipëri). Pra kuptohet lehtësisht që depozitimi në SPE nga ana jonë i dokumentave "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", është një depozitim fakultativ prej nesh, për të ofruar garanci shtesë për AK përveç detyrimit të plotësuar nëpërmjet Auto-Deklarimit në Annex 8.

b. KVO pretendon se "Të tre vërtetimet për paraqitjen e Bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin".

Së pari, sic kemi sqaruar më sipër, është e qartë, se kemi të bëjmë me dokumenta, ose më saktë komunikime elektronike të të dhënave, të cilat në origjinal ekzistojnë vetëm në versionin elektronik. Për efekt të noterizimit të përkthimit, këto dokumenta printohen bashkohen e lidhen me vulat e noterit me dokumentat e përkthyer në shqip, si edhe skanohen nga versioni print për tu upload në SPE, por nuk mund të konsiderohen si kopje të origjinalit, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston në letër. Për më tepër, sic edhe sqaruam më sipër këto nuk janë dokumenta të mirëfillta por komunikime elektronike të të dhënave, pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë nuk ekziston një i tillë në letër.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e KVO se Vërtetimet e përkthimit janë të pavlefshme sepse kanë vetëm numër repertori dhe jo datë, sqarojmë se:

- *Ligji Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në nenin 3 gërma "ë", nenet 62, 63, 97, 106 dhe në Kreun III të ligjit, përcakton në mënyrë të qartë aktet noteriale si të dallueshme nga veprimet noteriale. Gjithashtu, është e qartë se Ligji në fjalë, por edhe Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale" i cituar nga KVO, "vërtetimin e përkthimit" e përcakton si "veprim noterial" dhe jo si "akt noterial".*
- *Neni 105 i Ligjit Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", të cilit i referohet KVO, bën fjalë për detyrueshëm të "aktit noterial" dhe kjo del qartë duke filluar që nga titulli i nenit dhe më tej nga përmbajtja e tij, ku specifikisht i referohet "aktit noterial" pa përfshirë "veprimin noterial". Nga ana tjetër edhe neni 135 të cilit i referohet KVO, që rregullon veprimin noterial të "vërtetimit të përkthimeve" nuk bën fjalë për datën si element të detyrueshëm.*
- *KVO e AK, në mënyrë tërësisht të kundraligjshme, deklaroi se vërtetimet e përkthimeve në fjalë konsiderohen "të pavlefshme". Kjo për dy arsye: (i) sepse sipas nenit 137 të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", janë përcaktuar qartë rastet e pavlefshmërisë së aktit noterial dhe veprimit noterial, dhe mungesa e datës (gërma "d" dhe "e" e nenit) e përcaktojnë mungesën e datës si element pavlefshmërie vertëm për aktin noterial dhe jo edhe për veprimin noterial; dhe (ii) sipas nenit 138 të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", rezultoi qartë se akti ose veprimi noterial deklarohen të pavlefshëm vetëm nga Gjykata pasi kjo është vënë në lëvizje nga personat e treguar në këtë nen. Pra KVO nuk ka asnjë tagër të deklarojë pavlefshmërinë e këtyre veprimeve noteriale.*
- *Së fundmi, për të qartësuar më mirë këtë qëndrim të kundraligjshëm të KVO, po paraqesim bashkëlidhur kësaj Ankese Shtojcën 6, nëpërmjet të cilës konfirmohet edhe një herë nga noteri rregullshmëria e vërtetimeve të përkthimit të bera prej saj, të depozituara në këtë procedurë.*

Pra, shkaqet e skualifikimit (4), (5) dhe (6) nuk qëndrojnë

III. Në lidhje me shkakun (7) të skualifikimit

a. KVO pretendon se "Dokumenti "Konfirmim i xhiros" i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019 nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile".

Sic e kemi sqaruar edhe më sipër, ky dokument i lëshuar nga një autoritet publik, është një dokument dixhital i lëshuar me nënshkrim elektronik. Këtë fakt e kemi provuar edhe nëpërmjet depozitimit në SPE të dokumentit të emërtuar "SI 3.2 1 verifica firma digitale attestazione Ist

Rizzoli". Në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitalë.

b. KVO pretendon se "Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin".

Së pari, sic kemi sqaruar më sipër, është e qartë, se kemi të bëjmë me dokumenta dixhitalë të nënshkruar elektronikisht. Për efekt të noterizimit të përkthimit, këto dokumenta printohen bashkohen e lidhen me vulat e noterit me dokumentat e perkthyer në shqip, si edhe skanohen nga versioni print për tu upload në SPE, por nuk mund të konsiderohen si kopje të origjinalit, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston në letër. Pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë nuk ekziston një i tillë në letër por vetëm dokumenti dixhital/elektronik.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e KVO se Vërtetimet e përkthimit janë të pavlefshme, e kemi sqaruar kundërshtimin tonë me argumentat në pikën II.b më sipër në këtë ankesë.

Pra, shkakut i skualifikimit (7) nuk qëndron

I. Në lidhje me shkaqet (8) dhe (9) të skualifikimit

Për sa i përket shkakut (8) të skualifikimit, për të evituar rënien në përsëritje, ju referojmë në sqarimin e kundërshtimit tonë me argumentat në pikën II.b më sipër në këtë ankesë.

Për sa i përket shkakut (9) të skualifikimit, për të evituar rënien në përsëritje, ju referojmë në sqarimin e kundërshtimit tonë me argumentat në pikën I.b dhe II.a më sipër në këtë ankesë.

Pra, shkaqet e skualifikimit (8) dhe (9) nuk qëndrojnë.

Në përfundim, duam të theksojmë se, ne kemi ofruar në këtë procedurë vlerën ekonomikisht më të favorshme me një diferencë prej rreth 98 milion lekë ose 820.000 Euro, dhe për më tepër anëtar i BOE Servizi Italia s.p.a është kompania lider në Itali dhe me përmasa e shtrirje të sukseshme ndërkombëtare për ofrimin e këtij shërbimi. Kjo do të thotë, se cdo artific i krijuar për skualifikim të sforcuar të ofertës sonë, nëse do të synohej në lidhjen e kontratës me vlerë më të madhe do, jo vetëm do të shkaktonte dëm ekonomik për buxhetin, por edhe do të cënonte rëndë interesin publik, duke mohuar ofrimin e shërbimit nga një operator me kredenciale të forta dhe histori suksesi ndërkombëtare.

Kemi dorëzuar ankesën përkastëse pranë AK me nr. 1648 datë 25.09.2019 (Shtojca 3).

AK ka kthyer përgjigje për ankesën tonë me shkresën nr. 1648/2 datë 02.10.2019 të marrë në dorëim nga ana jonë më datë 04.10.2019 (Shtojca 8).

KSHA e AK në përgjigjen e vet nuk ka sjellë asnjë argument ligjor për refuzimin e ankesës sonë, por thjesht ka ripërsëritur qëndrimin e mbajtur nga KVO, madje nuk i ka dhënë përgjigje një nga një të gjitha argumentave tona, duke i anashkalluar ato, ndaj ne i qëndrojmë argumentave të përcjellë prej nesh në ankesën e dorëzuar në AK.

Kërkojmë nga Komisioni i Prokurimit Publik të shqyrtojë me seriozitet dhe përgjegjshmëri ligjore këtë ankesë tonën dhe ta pranojë atë duke shfuqizuar vendimin e AK për skualifikimin e ofertës sonë duke udhëzuar AK të na kualifikojë dhe të pranojë ofertën tonë si të vlefshme.

II.7. Në datën 21.10.2019, nëpërmjet shkresës me nr. 1729/1 prot., datë 21.10.2019, me objekt: “Dërgim dokumentacioni për procedurën e prokurimit me objekt “Për shërbimin e lavanderisë dhe hotelerisë për pacientët e hospitalizuar në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyet e skualifikimit: “1. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 19042917243251703, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar “Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018” nuk është i nënshkruar nga anëtarë i BOE-së Servizi Italia SPA.

2. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2017” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 18043013003466134, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2018 - Periudha tatimore 2017" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

3. Dokumenti "Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2016" i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian "Agjencia e të Ardhurave", me nr.protokolli 17022812551019395, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar "Modeli i TVSH 2017 - Periudha tatimore 2016" nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA", nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, pika 3.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1 është përcaktuar kriteri: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit".

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimes rezulton se është paraqitur dokumenti me emërtimin Marrëveshje e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë "Sanitary Cleaning" sh.p.k. dhe shoqërisë "Servizi Italia" s.p.a., nga ku shoqëria "Sanitary Cleaning" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 10% të vlerave të shërbimit, ndërsa shoqëria "Servizi Italia" s.p.a. merr përsipër të kryejë 90% të vlerave të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Sanitary Cleaning" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "Servizi Italia" s.p.a. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon :

- Dokumenti me emërtimin "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2016";
- Dokumenti me emërtimin "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2017";
- Dokumentin me emërtimin "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2018";

Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

- Dokumenti me emërtimin "SI 3.1.1 2017 Ricevuta Invio Telematico IVA";
- Dokumentin me emërtimin "SI 3.1.1 2018 Ricevuta Invio Telematico IVA";
- Dokumentin me emërtimin "SI 3.1.1 2019 Ricevuta Invio Telematico IVA"Sy0, së bashku Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;
- Dokumenti me emërtimin Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia, ku deklarohet nga kjo shoqëri në cilësinë e operatorit ekonomik të huaj, në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues rezulton se, ky dokumentacion si më sipër listuar, i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, është përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe të konfirmuara nga noteri.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

III.1.6. Në nenin 135 të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, përcaktohet shprehimisht se: *“Përkthimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga Ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi.”*

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit të mësipërm, Komisioni konstaton se, këto dokumenta janë paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike origjinale pra siç gjenerohen nga sistemi elektronik, pasi janë dokumenta në origjinal në versionin elektronik, në kushte kur në shtetin italian të cilit i përket dokumentacioni, këto dokumenta gjenerohen nga sistemi elektronik dixhital, si edhe janë të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe të konfirmuara nga noteri. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, në procedurat e prokurimit publik, për autoritetet kontraktore është e rëndësishme që operatorët ekonomikë me dokumentacionin e tyre, përveç se të vërtetojnë se disponojnë kapacitetet e nevojshme ligjore, financiare dhe teknike, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesin dokumentacionin administrativo-ligjor që vërteton këto kapacitete në mënyrën dhe formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në të kundërt dokumentacioni i paraqitur jo në formën e kërkuar është i pavlefshëm. Ligji për noterinë e ka të shprehur qartë se përkthimi i një dokumenti shkruhet në fund ose përbri tij dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri sipas ligjit ose përkthyesi dhe nënshkrimi i këtij të fundit vërtetohet nga noteri çka do të thotë që për dokumentat e lëshuara në gjuhë të huaj përkthimi në gjuhën shqipe duhet të kryhet sipas formës së përcaktuar.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i dorëzuar në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 8 në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, është formalisht në përputhje me parashikimet ligjore për noterinë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.1.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues përse i përket arsyes së skualifikimit se *“Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 "Kapaciteti i ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT”*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.8.1. Në dokumentat e tenderit shtojca 8, autoriteti kontraktor ka përcaktuar: *“Për operatorët ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikat 3.1 dhe 3.2 "Kapaciteti teknik”, nëse dokumentet e kërkuara ose ekuivalentet me to nuk ekzistojnë, sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë duhet të paraqesin vetë deklaratimet e tyre në përmbushje të secilit prej këtyre kriterëve.*

Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e zyrtare të huaja".

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj”, duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

III.1.8.2. Operatori ekonomik ankimues pretendon se: *“KVO pretendon se "Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile".*

Së pari, sic sqaruar edhe më sipër, ky dokument nuk mund të jetë i nënshkruar si dokumentat zyrtarë të prodhuar në letër, pasi është në vetvete nuk është një akt i mirëfilltë administrativ, por dokument që shërben si provë/konfermë e komunikimit elektronik.

Së dyti, duke mos qenë akt administrativ i mirëfilltë, ky nuk është një dokument nga ato që ka të detyrueshme pajisjen me vulë elektronike/dixhitale, pasi është një dokument dixhital i formës "konfermë elektronike", autenticiteti i të cilit, në përputhje me aktet ligjore italiane të cituara më sipër, sigurohet nëpërmjet autentifikimit të llogarive të përdoruesve në secilin prej skajeve të komunikimit, nga një anë llogaria e përdoruesit të administratës publike dhe nga ana tjetër, llogaria e certifikuar e përdoruesit nga kompania.

Së treti, në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitale.

III.1.8.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, konstatohet se, dokumentacioni i paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, është i gjeneruar nga sistemi elektronik dixhital dhe si i tillë nuk mund të përmbajë emër, mbiemër, firmë të zyrtarit përkatës dhe vulë të institucionit lëshues (tatimor), ashtu siç mund të jetë çdo dokument tjetër zyrtar i prodhuar në formë shkresore, pasi, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me akte të mirëfillta administrative sipas legjislacionit përkatës në fuqi të shtetit italian. Për më tepër, që në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur edhe dokumentin elektronik përkatës (pra të gjeneruar po nga sistemi elektronik i shtetit italian), si provë të depozitimit në formë elektronike të këtyre deklaratave.

Në Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 322/1998 (të shtetit italian) në nenin 3, paragrafi 10 i tij citohet: “Prova e paraqitjes së deklaratës bëhet nga mandati i bankës ose zyrës postare ose nga mandati i dërgesës rekomande të përmendur në paragrafin 5 ose nga komunikimi i administratës financiare që vërteton pranimin e deklaratës së paraqitur në mënyrë elektronik”.

Ndërsa në Dekretin e Ministrisë së Financës po të shtetit italian datë 31.07.1998, në nenin 9, paragrafi 8 të tij citohet se: “Me përjashtim të rasteve të forcës madhore, konfirmimet e paraqitjes bëhen të disponueshme në mënyrë elektronike brenda pesë ditëve pune nga dërgimi i dosjeve të deklaratave të cilave u referohen dhe për një periudhë jo më pak se tridhjetë ditë pune” .

Në dekretin legjislativ të datës 7 mars 2005, në nenin 5 bis të tij përcaktohet se: “Paraqitja e kërkesave, deklaratave, të dhënave dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumentave, qoftë edhe për qëllime statistikore, ndërmjet kompanive dhe administratës publike, bëhet në mënyrë ekskluzive duke përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikacionit. Me të njëjtat modalitete administrata publike miratojnë dhe komunikojnë akte dhe masa administrative ndaj kompanive”.

Sa më sipër, vërtetohet qartësisht se, legjislacioni përkatës në fuqi në Itali, detyron komunikimin elektronik për depozitimin dhe konfirmimet e dokumentave apo akteve të ndryshme financiare. Në rastin konkret nga ana e operatorit ekonomik ankimues është depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike dokumenti i ngarkuar në mënyrë elektronike në sistemin e tyre elektronik për deklarimin e TVSH dhe xhiros vjetore, e si i tillë, rrjedhimisht nuk është në formën e një akti shkresor për të cilin duhet të ketë emër, mbiemër e nënshkrim zyrtar dhe vulë të lëshuar nga administrata përkatëse. Rrjedhimisht këto dokumenta nuk janë akte administrative të lëshuara nga organe publike, por janë dokumenta që vërtetojnë transmetimet elektronike dhe që shërbejnë si konfirmim / vërtetim të komunikimit elektronik.

Gjithashtu, rezulton se, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike edhe dokumentin me emërtimin “Annex 8 – Auto deklaratë”, në të cilën është deklaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk e lejon mundësinë e legalizimit apo mundësinë që dokumentat të pajisen me vulë apostile të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitale.

Në rastin konkret, ashtu siç edhe ankimuesi pretendon, dokumenti është gjeneruar nga sistemi elektronik i shtetit italian, nga i cili janë nxjerrë këto dokumenta dhe si të tillë nuk mund të jenë si

dokumenta të mirëfillta zyrtare dhe rrjedhimisht nuk mund të legalizohen e të pajisjen me vulën apostile, përse kohë që ato janë akte të lëshuara apo gjeneruara në mënyrë elektronike nga sistemi elektronik përkatës. Në këto kushte dokumenta të tilla të nxjerra nga sistemi elektronik i shtetit italian, të cilat nuk janë si aktet zyrtare të lëshuara nga organe të administratës publike dhe të pajisura me emër, mbiemër, firmë të zyrtarit përkatës dhe vulë të institucionit lëshues, nuk është e detyrueshme që të legalizohen dhe pajisen me vulë apostile në përputhje me legjislacionin në fuqi për legalizimin e akteve zyrtare të lëshuara nga autoritetet e huaja dhe që do të përdoren brenda vendit. Sqarojmë se në VKM nr. 134, datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit”, është përcaktuar qartësisht mënyra e legalizimit të dokumentave të autoriteteve të huaja që do të përdoren brenda vendit, pra të dokumentave zyrtare të cilat janë lëshuar nga autoritete të huaja, ndërkohë që në rastin konkret kemi të bëjmë me dokumenta të gjeneruara nga sistemi elektronik dhe jo dokumenta të lëshuara nga autoritetet zyrtare.

Për më tepër, që dokumentat për të cilat autoriteti kontraktor ka dhënë arsyet e skualifikimit, konstatohet se, janë thjesht dokumenta të depozituara në sistemin e prokurimeve elektronike me emërtimin “Komunikim i marrjes së deklaratës”, të cilat, janë ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike për të vërtetuar si dokument shtesë, që operatori ekonomik disponon kapacitetet për xhiron sipas kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.1.9. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se “dokumenti i emërtuar – Modeli i TVSH 2019, nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA”, operatori ekonomik ankimues pretendon se “...aktet ligjore dhe nënligjore italiane në fuqi dhe konkretisht Dekreti Legjislativ 82/2005 “Codice dell’amministrazione digitale” dhe Dekreti drejtues (Ministria e Financave) i datës 31/07/1998, përcaktojnë ndër të tjera që transmetimi dhe paraqitja e deklarimeve si ai i xhiros, bëhen nëpërmjet përcjelljes elektronike të këtyre deklarimeve nga kompanitë, sipas formularëve (moduleve elektronikë) të miratuar paraprakisht, duke përdorur llogaritë e autentifikuara/certifikuara të përdoruesve. Pra, nuk ka se si të kërkohet që ky dokument të jetë i nënshkruar nga shoqëria Servizi Italia, pasi nënshkrimi që përdoret zakonisht në dokumentat në letër, në këtë rast është zëvendësuar nga autentifikimi/certifikimi i llogarisë së përdoruesit, sipas modaliteteve të përcaktuara në legjislacionin italian në fuqi”.

Në këto kushte, sa më sipër argumentuam, referuar bazës ligjore të cituar të shtetit italian, të cilit i përket edhe shoqëria ankimuese pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi, dokumenti i cili është ngarkuar në mënyrë elektronike dhe që është një dokument i nxjerrë nga sistemi elektronik dixhital, rrjedhimisht, nuk përmban nënshkrim nga ana e shoqërisë, pasi ajo është ngarkuar dhe nxjerrë në sistemin elektronik nga llogaria personale e çertifikuar e përdoruesit përkatës që në rastin konkret është shoqëria Servizi Italia s.p.a. Pra, fakti që dokumenti është përcjellë elektronikisht nga adresa apo llogaria e çertifikuar e përdoruesit Servizi Italia, vërteton rrjedhimisht se, nuk kemi të bëjmë me dokument shkresor për të cilin është e domosdoshme

nënshkrimi përkatës, pasi kjo vërtetohet me dërgimin elektronik nga adresa autentike e një përdoruesi.

III.1.10. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një ndër parimet kryesore të përzgjedhjes referuar edhe nenit 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar është edhe mosdiskriminimi dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues përmbush kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyet e skualifikimit "4. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2016 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr.PRA/1509/2017/CPRAUTO datë 12.05.2017, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

5. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2017 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr.PRA/12732/2018/CPRAUTO, datë 14.05.2018, lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s'ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s'ka vulë elektronike/digitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT

6. Dokumenti "Vërtetim për paraqitjen në mënyrë telematike pranë zyrës së Regjistrimit të Ndërmarrjeve të Parma", të bilancit për vitin 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, me Nr. PRA/210570/2019/CPRAUTO, datë 19.06.2019; lëshuar nga institucioni Dhoma e Tregtisë Parma, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1(2) "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Të tre vërtetimet për paraqitjen e Bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuara me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm, pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij", nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, pika 3.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2 është përcaktuar kriteri: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: 2016, 2017, 2018 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore"*.

III.2.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimues rezulton se është paraqitur dokumenti me emërtimin Marrëveshje e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë "Sanitary Cleaning" sh.p.k. dhe shoqërisë "Servizi Italia" s.p.a., nga ku shoqëria "Sanitary Cleaning" sh.p.k. merr përsipër të kryejë 10% të vlerave të shërbimit, ndërsa shoqëria "Servizi Italia" s.p.a. merr përsipër të kryejë 90% të vlerave të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria "Sanitary Cleaning" sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.2.3. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik "Servizi Italia" s.p.a. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon :

- Dokumenti me emërtimin *"SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2016_EN"*;
- Dokumenti me emërtimin *"SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2017_EN"*;
- Dokumenti me emërtimin *"SI 3.1.2 FS separated and consolidated 2018_EN"*;

Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

- Dokumenti me emërtimin *"SI 3.1.2 FS 2016 official submission"*;
- Dokumentin me emërtimin *"SI 3.1.2 FS 2017 official submission"*;
- Dokumentin me emërtimin *"SI 3.1.2 FS 2018 official submission"*;

Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

- Dokumenti me emërtimin Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia, ku deklarohet nga kjo shoqëri në cilësinë e operatorit ekonomik të huaj, në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

III.2.4. Në lidhje me arsyen e skualifikimit të dhënë për bilancet nga ana e autoritetit kontraktor, përse i përket vulës apostile; faktit se nuk ka emër, mbiemër, firmë vulë institucioni / as elektronikisht, si edhe faktit se dokumentat nuk janë të njehsuara me origjinalin, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, i qëndron argumentimit dhe arsyesimit të bërë në pikën III.1. të këtij vendimi e si rrjedhim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik përse i përket arsyes së skualifikimit se të treja vërtetimet për paraqitjen e bilanceve janë përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, por në vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr. Repertori, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se :

III.2.5.1. Operatori ekonomik ankimes pretendon se :

- *Ligji Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", në nenin 3 gërma "ë", nenet 62, 63, 97, 106 dhe në Kreun III të ligjit, përcakton në mënyrë të qartë aktet noteriale si të dallueshme nga veprimet noteriale. Gjithashtu, është e qartë se Ligji në fjalë, por edhe Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale" i cituar nga KVO, "vërtetimin e përkthimit" e përcakton si "veprim noterial" dhe jo si "akt noterial".*
- *Neni 105 i Ligjit Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", të cilit i referohet KVO, bën fjalë për detyrueshëm të "aktit noterial" dhe kjo del qartë duke filluar që nga titulli i nenit dhe më tej nga përmbajtja e tij, ku specifikisht i referohet "aktit noterial" pa përfshirë "veprimin noterial". Nga ana tjetër edhe neni 135 të cilit i referohet KVO, që rregullon veprimin noterial të "vërtetimit të përkthimeve" nuk bën fjalë për datën si element të detyrueshëm.*
- *KVO e AK, në mënyrë tërësisht të kundraligjshme, deklaroi se vërtetimet e përkthimeve në fjalë konsiderohen "të pavlefshme". Kjo për dy arsye: (i) sepse sipas nenit 137 të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", janë përcaktuar qartë rastet e pavlefshmërisë së aktit noterial dhe veprimit noterial, dhe mungesa e datës (gërma "d" dhe "e" e nenit) e përcaktojnë mungesën e datës si element pavlefshmërie vertëm për aktin noterial dhe jo edhe për veprimin noterial; dhe (ii) sipas nenit 138 të Ligjit Nr.110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", rezultoi qartë se akti ose veprimi noterial deklarohen të pavlefshëm vetëm nga Gjykata pasi kjo është vënë në lëvizje nga personat e treguar në këtë nen. Pra KVO nuk ka asnjë tagër të deklarojë pavlefshmërinë e këtyre veprimeve noteriale.*
- *Së fundmi, për të qartësuar më mirë këtë qëndrim të kundraligjshëm të KVO, po paraqesim bashkëlidhur kësaj Ankese Shtojcën 6, nëpërmjet të cilës konfirmohet edhe një herë nga noteri rregullshmëria e vertetimeve të përkthimit të bera prej saj, të depozituara në këtë procedurë.*

Pra, shkaqet e skualifikimit (4), (5) dhe (6) nuk qëndrojnë

III.2.5.2. Në nenin 137 të ligjit 110/2018 "Për noterinë", është përcaktuar:

"Aktet dhe veprimet noteriale të pavlefshme

Veprimet dhe aktet noteriale janë të pavlefshme në të gjitha rastet kur pavlefshmëria parashikohet shprehimisht në ligj, ose është një sanksion i nevojshëm, sipas qëllimit të ligjit, veçanërisht në rastet në vijim, por pa u kufizuar në to:

a) kryerja e tyre është në kompetencën e një organi tjetër shtetëror;

b) në aktin ose në veprimin noterial kanë marrë pjesë personat që tregohen në nenin 98 të këtij ligji;

- c) akti noterial përmban disponim në dobi të personave, për të cilët parashikohen ndalime sipas nenit 98 të këtij ligji;
- ç) akti noterial ose vërtetimi i nënshkrimeve nuk janë nënshkruar personalisht nga palët ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar;
- d) në aktin noterial nuk tregohet identiteti i palëve, data dhe vendi ku është bërë;
- dh) akti ose veprimi noterial nuk përmban nënshkrimin e palëve ose nuk është nënshkruar dhe vulosur me të dyja vulat nga noteri;
- e) akti noterial është hartuar pa u respektuar rregullat e parashikuara në pikën 2, të nenit 105, të këtij ligji”.

III.2.5.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, rezulton se, ky dokumentacion si më sipër listuar, i paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik, është i përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes zyrtar të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë dhe të konfirmuara nga noteri. Përsa i përket dokumentit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konstatohet se, ai përmban elementët kryesorë e të domosdoshëm, të cilët nuk e kthejnë atë në të pavlefshëm, si edhe nuk çenojnë përmbajtjen e tij.

III.2.5.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se dokumenti noterial në kuptim të ligjit për noterinë dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, përmban elementët kryesorë e të domosdoshëm të cilët nuk e kthejnë këtë dokument në të palvlefshëm, përcaktim ky, i cili, është përkufizuar shumë qartë në ligjin për noterinë.

Si rrjedhim sa më sipër analizuar pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit: *“7.Dokumenti “Konfirmim i xhiros” i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019 nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.2(1) “Kapaciteti teknik” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.*

Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij", nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, pika 3.2. Kapaciteti teknik, pika 1 është përcaktuar kriteri: *“Operatori ekonomik duhet të paraqese deshmi per realizimin e shërbimeve të meparshme, të ngjashme, të realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne nje vlere jo me te vogel se 40 % e vleres se fondit limit. Realizimi i shërbimeve të ngjashme duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë:*

- a) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me institucione shtetërore, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror për realizimin e shërbimeve ose faturat tatimore të shitjes;*
- b) *Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të jenë shënuar datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara”.*

III.3.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimes rezulton se është paraqitur dokumenti me emërtimin Marrëveshje e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. dhe shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a., nga ku shoqëria “Sanitary Cleaning” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 10% të vlerave të shërbimit, ndërsa shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. merr përsipër të kryejë 90% të vlerave të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Sanitary Cleaning” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.3.3. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “ Servizi Italia ” s.p.a. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon :

- Dokumenti me emërtimin “SI 3.2.1 Attestazione servizio Ist – Rizzoli”;
- Dokumenti me emërtimin “SI 3.2.1 Translation similar contracts”;
- Dokumentin me emërtimin "SI 3.2.1 Verifica firma digitale attestazione”;

Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

- Dokumenti me emërtimin Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia, ku deklarohet nga kjo shoqëri në cilësinë e operatorit ekonomik të huaj, në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

III.3.4. Operatori ekonomik ankimes argumenton se : *“a. KVO pretendon se "Dokumenti "Konfirmim i xhiros" i paraqitur për të provuar shërbime të ngjashme të mëparshme për periudhën 2016, 2017, 2018 të anëtarit të BOE-së Servizi Italia SPA, lëshuar me datë 20.06.2019*

nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna - Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja, Itali, nuk përmban vulën Apostile".

Sic e kemi sqaruar edhe më sipër, ky dokument i lëshuar nga një autoritet publik, është një dokument dixhital i lëshuar me nënshkrim elektronik. Këtë fakt e kemi provuar edhe nëpërmjet depozitimit në SPE të dokumentit të emërtuar "SI 3.2 1 verifica firma digitale attestazione Ist Rizzoli". Në pikën 2 të Annex 8 "Auto - Deklaratë" (së bashku me shënimet fundore ilustruese), lëshuar nga Servizi Italia si operator ekonomik i huaj në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian, është sqaruar se legjislacioni italian në fuqi, nuk lejon mundësinë e legalizimit apo apostilimit të akteve dhe dokumentave elektronikë/dixhitalë.

b. KVO pretendon se "Ky dokument është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk është i njehsuar me origjinalin".

Së pari, sic kemi sqaruar më sipër, është e qartë, se kemi të bëjmë me dokumenta dixhitalë të nënshkruar elektronikisht. Për efekt të noterizimit të përkthimit, këto dokumenta printohen bashkohen e lidhen me vulat e noterit me dokumentat e përkthyer në shqip, si edhe skanohen nga versioni print për tu upload në SPE, por nuk mund të konsiderohen si kopje të origjinalit, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me rastin tradicional kur dokumenti origjinal ekziston në letër. Pra nuk ka asnjë nevojë për njësim me origjinalin, për sa kohë nuk ekziston një i tillë në letër por vetëm dokumenti dixhital/elektronik.

Së dyti, në lidhje me pretendimin e KVO se Vërtetimet e përkthimit janë të pavlefshme, e kemi sqaruar kundërshtimin tonë me argumentat në pikën II.b më sipër në këtë ankesë.

III.3.5. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se dokumenti i lëshuar nga institucioni Shërbimi Shëndetësor Rajonal Emilia Romagna-Instituti Ortopedik Rizzoli, Bolonja Itali, nuk përmban vulën apostile, si edhe faktit se dokumentat nuk janë të njehsuara me origjinalin, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, i qëndron argumentimit dhe arsytimit të bërë në pikën III.1. të këtij vendimi e si rrjedhim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.3.6. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se tek dokumenti i përkthimit nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit, por vetëm nr. repertori, Komisioni i Prokurimit Publik i qëndron argumentimit dhe arsytimit të bërë në pikën III.2.5. të këtij vendimi e si rrjedhim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyet e skualifikimit "8. I gjithë dokumentacioni i vetdeklaruar në institucionin italian INAIL, i paraqitur ne tender nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA, për të provuar pasjen e fuqisë punëtore, është përkthyer nga gjuha italiane në gjuhën shqipe, nga përkthyes i licencuar nga Ministria e Drejtësisë, por në Vërtetimin e firmës së përkthyesit të redaktuar nga noteri publik, nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr.repertori, si dhe nuk janë të njehsuar me origjinalin. Ky vërtetim është i pavlefshëm pasi bie në kundërshtim me Ligjin për Noterinë Nr. 110, datë 20.12.2018, neni 105 dhe neni 135 të tij dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë Nr. 6291, datë 17.08.2005 "Për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale", pika 2 dhe 3 e tij.

9. Dokumentacioni “Njoftim i detyrueshëm” i Administratës së Provincës Parma - Shërbimi i Formimit Profesional dhe Politikave Aktive të Punës, Itali, nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Për rrjedhim, ofertuesi BOE - Servizi Italia SPA + Sanitary Cleaning SHPK nuk arriti të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3 (3) të kapacitetit teknik të dokumentave të tenderit, për fuqinë punëtore”, nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.4.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, pika 3.2. Kapaciteti teknik, pika 3 është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar jo me pak se 60 (gjashtedhjetë) punonjës në sektorin e shërbimit të lavandarisë për periudhën Gusht 2018 - Korrik 2019, e vërtetuar me:

- a) Vërtetim nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar të shoqëruar dhe me listëpagesat (formularet E-sig 025 a) të konfirmuara nga autoritetet përkatëse.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton se disponon personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës si më poshtë vijon:

Fuqia punëtore që kërkohet nga autoriteti kontraktor;

Nr	Personeli	Nr minimal i punonjësve
1	Punëtorë në Lavanderi	15
2	Punëtorë ngarkim shkarkimi	8
3	Punonjës shërbimi/Infermier i specializuar	30
4	Shofer/ Punonjës Mirembajtje	4
5	Magaziniere	1
6	Pergjegjes sektori	2
TOTALI		60

- c) Për punonjësit e sipërkërkuar operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata pune të vlefshme, librezat e tyre të punës si dhe librezat shëndetësore ku të vërtetohet se nuk janë mbartës të sëmundjeve infektive.
- d) Punonjësit e mësipërm duhet të kenë të paktën 1 vitë eksperiencë pune në profilin e kërkuar”.

III.4.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimes rezulton se është paraqitur dokumenti me emërtimin Marrëveshje e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. dhe shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a., nga ku shoqëria “Sanitary Cleaning” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 10% të vlerave të shërbimit, ndërsa shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. merr përsipër të kryejë 90% të vlerave të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Sanitary Cleaning” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.4.3. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “ Servizi Italia ” s.p.a. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon :

- Dokumenti me emërtimin “SI 3.2.3 Translation Employees, part 1

- Dokumenti me emërtimin “SI 3.2.3 Translation Employees, part 2
 - Dokumenti me emërtimin “SI 3.2.3 Translation Employees, part 3
- Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;
- Dokumenti me emërtimin Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia, ku deklarohet nga kjo shoqëri në cilësinë e operatorit ekonomik të huaj, në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

III.4.4. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se tek dokumenti i përkthimit nuk rezulton data e lëshimit të vërtetimit por vetëm nr. repertori, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, i qëndron argumentimit dhe arsytimit të bërë në pikën III.2.5. të këtij vendimi e si rrjedhim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4.5. Në lidhje me arsyen e skualifikimit se dokumentat nuk janë të njehsuara me origjinalin, Komisioni i Prokurimit Publik i qëndron argumentimit dhe arsytimit të bërë në pikën III.1. të këtij vendimi e si rrjedhim pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4.6. Në lidhje me arsyen e skualifikimit të dhënë se dokumenti “Njoftim i detyrueshëm” i Administratës së Provincës Parma, nuk ka vulën apostile, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, i qëndron argumentimit dhe arsytimit të bërë në pikën III.1. të këtij vendimi.

Për më tepër, që dokumentat për të cilat autoriteti kontraktor ka dhënë arsyet e skualifikimit, konstatohet se, janë thjesht dokumenta të depozituara në sistemin e prokurimeve elektronike me emërtimin “Njoftim i detyrueshëm” i Administratës së Provincës Parma”, të cilat, janë ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike për të vërtetuar si dokument shtesë, që operatori ekonomik disponon kapacitetet për punonjësit sipas kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit (konkretisht ky dokument është konfirmimi i depozitimit të librezës së punës online, konfirmim ky, që si dokument është gjeneruar po nga sistemi elektronik).

Bazuar në nenin 1, pika 2, a, b, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kpp gjykon se qëllimet e ligjit për prokurimin publik janë që të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik të kryera nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër, gjykojmë se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

Vendos

1. Të pranohet ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 30830-07-18-2019, me objekt “Për shërbimin e

lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 1.117.059.801 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1613 Protokoli

Datë 11.10.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar	Anëtar	Anëtar
Vilma Zhupaj	Lindita Skeja	Merita Zeqaj

Nënkryetar
Enkeleda Bega



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Enkeleda Bega (Nënkryetar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtare e KPP shpreh mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. konkretisht nuk jam dakord me të gjithë arsyetimin e vendimit dhe me dispozitivin, për sa i përket çështjes me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-30830-07-18-2019, me objekt “Për shërbimin e lantërisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 1.117.059.801 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara”.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyetoj:

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyet e skualifikimit: “1. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2018” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 19042917243251703, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë të institucionit tatimor) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT. Gjithashtu, dokumenti i emërtuar ”Modeli i TVSH 2019 - Periudha tatimore 2018” nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

2. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2017” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 18043013003466134, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar “Modeli i TVSH 2018 - Periudha tatimore 2017” nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA.

3. Dokumenti “Komunikim i marrjes së deklaratës - Modeli i deklaratës: TVSH 2016” i lëshuar nga administrata tatimore e shtetit italian “Agjencia e të Ardhurave”, me nr.protokolli 17022812551019395, është i përkthyer nga përkthyes zyrtar nga gjuha italiane në gjuhën shqipe por nuk është i njehsuar me origjinalin. Ky dokument nuk është i nënshkruar as zyrtarisht (s’ka emër mbiemër, firmë, vulë institucioni) dhe as elektronikisht (s’ka vulë elektronike/ digjitale), si dhe nuk përmban vulën Apostile, duke mos plotësuar kriterin e përcaktuar në pikën 3.1 “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” si dhe kushtin e përcaktuar për operatorët ekonomik të huaj, sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim Shtojca 8 e DT.

Gjithashtu, dokumenti i emërtuar “Modeli i TVSH 2017 - Periudha tatimore 2016” nuk është i nënshkruar nga anëtari i BOE-së Servizi Italia SPA”, nuk qëndrojnë, vërej se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, pika 3.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 1 është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit”.

III.1.2. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorit ekonomik ankimes rezulton se është paraqitur dokumenti me emërtimin Marrëveshje e Bashkimit të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. dhe shoqërisë “Servizi Italia” s.p.a., nga ku shoqëria “Sanitary Cleaning” sh.p.k. merr përsipër të kryejë 10% të vlerave të shërbimit, ndërsa shoqëria “Servizi Italia” s.p.a. merr përsipër të kryejë 90% të vlerave të shërbimit.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Prokurë e Posaçme, sipas së cilës shoqëria “Sanitary Cleaning” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Servizi Italia” s.p.a. ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë vijon :

- Dokumenti me emërtimin “SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2016”;
- Dokumenti me emërtimin “SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2017”;
- Dokumentin me emërtimin "SI 3.1.1 Dichiarazione IVA 2018";

Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;

- Dokumenti me emërtimin "SI 3.1.1 2017 Ricevuta Invio Telematico IVA";

- Dokumentin me emërtimin "SI 3.1.1 2018 Ricevuta Invio Telematico IVA";
- Dokumentin me emërtimin "SI 3.1.1 2019 Ricevuta Invio Telematico IVA" Shoqëruar këto dokumenta me përkthimin e noterizuar në gjuhën shqipe;
- Dokumenti me emërtimin Annex 8 "Auto - Deklaratë" lëshuar nga Servizi Italia, ku deklarohet nga kjo shoqëri në cilësinë e operatorit ekonomik të huaj, në lidhje me mundësinë dhe formën e lëshimit të dokumentave nga shteti italian.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Servizi Italia" s.p.a. si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë "Sanitary Cleaning" sh.p.k. & "Servizi Italia" s.p.a., ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në dokumentat e tenderit si më sipër listuar, por që janë dokumenta të cilave iu mungon vula apostile, në kundërshtim kjo me kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit shtojca 8, ku përcaktohet se: *"Për operatorët ekonomik të huaj në përmbushje të kriterëve të përcaktuara në pikat 3.1 dhe 3.2 "Kapaciteti teknik", nëse dokumentet e kërkuara ose ekuivalentet me to nuk ekzistojnë, sipas dispozitave të ligjit vendas të tij, atëherë duhet të paraqesin vetë deklaratimet e tyre në përmbushje të secilit prej këtyre kriterëve.*

Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës".

Autoriteti kontraktor në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, argumenton se *"Kushti i pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit për operatorët ekonomik të huaj që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hages (5 TETOR 1961), sic është edhe Italia, është që dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Shqipëria dhe Italia janë vende anëtare (që kanë ratifikuar/aderuar) të Konventës së Hages "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të 5 tetorit 1961, e për rrjedhim dokumentet e lëshuara nga institucionet shqiptare që do të perdoren në vendet anëtare të së njëjtes Konvente, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore.*

Në bazë të kësaj Konvente, dokumentet pajisen me një vule Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dokumentat (në rastin konkret Italia), edhe me pas mund të perdoren direkt në institucionin përkatës të vendit pritës (në rastin konkret Shqipëria).

Prandaj dokumentet që origjinojnë nga Italia, duhet të apostilohen para se të paraqiten pranë autoriteteve shqiptare. Autoritetet përgjegjëse për apostilimin e dokumenteve, ku përfshihet dhe shteti Italian, gjenden në adresën:

http://www.hcch.net/indeex_en.php?aet=conventions.authorities&cid=41.

Anetari i BOE-se "Servizi Italia SPA" duhet të kishte ndjekur procedurat prane autoriteteve kompetente italiane për pajisjen me vule Apostile të dokumentacionit zyrtar të leshuar nga institucionet italiane, përpara se ta paraqiste atë si pjesë të ofertes në procedurën e prokurimit (në një vend të huaj).

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga anetari i BOE-se "Servizi Italia SPA" për të provuar plotësimin e kriterëve dhe kërkesave të percaktuara në pikat 1 dhe 2 të seksionit 3.1 "Kapacitet ekonomik dhe financiar"; pikat 1 dhe 3 të seksionit 3.2 "Kapaciteti Teknik", si dhe kushtin e percaktuar për operatorët ekonomik të huaj sipas paragrafit të parafundit të kriterëve të vecanta për kualifikim, të percaktuara në Shtojcën 8 të dokumentave të tenderit, nuk rezultojnë të jete në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe as me kushtet e percaktuara në dokumentat e tenderit".

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".

III.1.6. Në VKM nr. 134, datë 7.3.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja, për përdorim brenda vendit", në pikën 4 të tij përcaktohet se: "[...] Dokumentat e autoriteteve të huaja që do të përdoren brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit ndërsa dokumentat e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme".

Akoma më tej në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

"Për operatorët ekonomik të huaj, që kanë regjistrim në shtetet anëtare të Konventës së Hagës (5 TETOR 1961), dokumentet e lëshuara duhet të përmbajnë vulën apostile në përputhje me ligjin nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Për operatorët ekonomikë të huaj, që kanë regjistrim në vendet që nuk e kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 05.10.1961 për "Heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumentave zyrtare të huaj", duhet të bëhen legalizimet e këtyre dokumentave në ambasadat, konsullatat ose zyrrat respektive nga vendi i origjinës

Operatorët e huaj ekonomikë, duhet të paraqesin të gjithë dokumentat e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara "Apostille". Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, "Për heqjen e kërkesës për legalizim

diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).”

III.1.7. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik ankimues duhej të dorëzonte të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve para hapjes së ofertave. Nuk duhet të ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.8. Konstatohet se, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit të xhiros vjetore nuk përmban asnjë vulë apo legalizim nga organet përkatëse kompetente. Sa më sipër, konstatohet se dokumentacioni i mësipërm i lëshuar nga një shtet i huaj nuk përmbush kushtet formale për përdorim në Republikën e Shqipërisë. Gjykoj se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi si edhe kriteret e kualifikimit të vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedureve të prokurimit publik. Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Servizi Italia” s.p.a. në këtë procedurë prokurimi, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe legjislacionit në fuqi dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

III.1.9. Sqaroj se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës

së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.*

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e tjera të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sanitary Cleaning” sh.p.k. & “Servizi Italia” s.p.a., për skualifikimin e padrejtë të tij, gjykoj se nuk kanë ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që nuk i janë pranuar disa prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike e juridike e këtij operatori nuk do të ndryshojë, por do të mbetet i skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke mos përmbushur interes të ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merren në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

Si rrjedhojë e arsytimit të bërë më sipër, në lidhje me dispozitivin e vendimit, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, gjykoj :

1. Të mos pranohet ankesa e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Servizi Italia” Spa & “Sanitary Cleaning” sh.p.k., për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF- 30830-07-18-2019, me objekt “Për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë në pavionet e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 1.117.059.801 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.09.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Nënkryetar

Enkeleda Bega